

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK
Për Programin e studimit Master Profesional në
"Qeverisje dhe Administrim Publik"
Ofruar nga Universiteti Privat "Albanian University"

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

PhD. Dorian JANO



PhD. Ilir KALEMAJ

(Prill / 2019)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik"

Universiteti Privat "Albanian University"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Privat "Albanian University"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit Vendimi i riorganizimit	VKM Nr. 597, datë 28.05.2009 Vendim Senati Nr. 192 prot, datë 25.01.2011
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër i MASH Nr. 499, datë 18.10.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik"
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucionet të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studentëve aktualë për këtë program studimi	28

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik"

Programi i studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" ofruar nga Universiteti Privat "Albanian University" është licencuar me VKM Nr. 597, datë 28.05.2009, si program i ciklit të dytë, Master i Nivelit të Parë (MNP). Në vitin 2011, bazuar dhe në ndryshimet e pësuara në ligjin e arsimit të larte, institucioni me Vendim të Senatit Akademik, të pasqyruara në Vendimin e Rektoratit Nr. 192, datë 25.01.2011, institucioni ka bërë ndryshimin e këtij programi në program të ciklit të dytë, Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik". Ky program studimi është akredituar për herë të parë me Urdhër të MASH Nr. 499, datë 18.10.2012, duke i vendosur detyrim plotësimin e rekomandimeve të vendosura nga Këshilli i Akreditimit në vendimin Nr. 363, datë 17.09.2012. Ky program studimi është ofruar me 90 ECTS (2012-2017) dhe është riorganizuar në 60 ECTS me kohëzgjatje 1 vit akademik, me Vendim Senati Nr. 6 datë 28.02.2018, vendim i cili është miratuar me shkresë MASR Nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018.

Programi i studimit, Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" ofrohet nga *Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative*, njësi bazë mesimore-kërkimore e cila përfshin fusha kërkimi në disiplinën e shkencave politiko-administrative, dhe pjesë përberese e Fakultetit të Shkencave Shoqërore pranë Universiteti Privat "Albanian University".

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

- 1. Dorian Jano, PhD**
- 2. Ilir Kalemaj, PhD**

Gjatë gjithë procedurës, ekspertët e jashtëm të vlerësimit janë asistuar nga specialistet e ASCAL: Znj. Xhiliola Bixheku dhe Znj. Majlinda Demirneli.

Universiteti Privat "Albanian University" është njojur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 07.03.2019, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 13/14 Prot, datë 08.03.2019. AU përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me Nr. 118/1 Prot, datë 12.03.2019 përgjigje në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Nëpërmjet kësaj shkrese Institucioni shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË




Këshilli i akreditimit me Vendimin Nr. 499 dt. 18.10.2012 vendosi akreditimin e programit të studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" duke i vendosur detyrim plotësimin e rekomandimeve si më poshtë vijon:

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

1. Në të ardhmen të shihet nga Albanian University mundësia e rritjes së numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe me grada e tituj shkencorë sepse kjo gjë do ta ndihmonte atë të plotësonte standardet lidhur me numrin e pedagogëve me kohë të plotë e të krijonte një profil të plotë të sajin (aktualisht rreth 15% e pedagogëve janë me kohë të plotë për programet MSH Administrim Publik me profile: a) Politika publike dhe BE, b) Politika publike dhe qeverisje, dhe MP Qeverisje dhe Administrim Publik, pra nuk e plotëson këtë standard; problem nga i cili vuajnë shumica dërrmuese e universiteteve private në Shqipëri);
2. Biblioteka të pasurohet me libra të autorëve të njohur të vendit dhe të huaj dhe të bëhen abonime në libraritë elektronike të universiteteve të njohura të huaja.
3. Lidhur me Zyrën e Karrierës në AU sugjerohet që t'i jepet hapësirë fizike më e madhe kësaj zyre në mënyrë që t'i kryejë më mirë funksionet e veta, dhe të japë një perceptim më të mirë në këndvështrimin e studentëve dhe palëve të tjera të interesuara.
4. Për programin MP Qeverisje dhe Administrim Publik, të shihet mundësia që në semestrin e fundit të studimeve master të përfshihen të paktën dy lëndë me zgjedhje, praktikë e hasur në shumë universitete të njohura botërore.
5. Të bëhet shumë promociion për tërheqjen në këto profile studimi të studentëve të rinj me rezultate të larta nga sistemi i studimeve Bachelor, me qëllim që të investohet shumë tek ata dhe të bëhen në të ardhmen lidera përkatësisht në fushën e administrimit publik.
6. Duhet vënë theksi në përmirësimin dhe azhornimin e vazhdueshëm të programeve të këtyre profileve duke u bazuar në literaturat më bashkëkohore dhe të autorëve të njohur të vendit dhe botërorë.
7. Të gjendet mënyra që lënda/syllabusi Acquis Communitaire të emërtohet në gjuhën shqipe, meqë PS zhvillohet në gjuhën shqipe.
8. Biblioteka të mbylljet e të izolohet nga zhurmat, të zgjerohet e të përshtatet për t'i krijuar më shumë komoditet të interesuarve për përdorimin e bibliotekës në AU.
9. Lidhur me plotësimin e kriterit 2 të standardit III.2, konstatohet se janë katër titullarë lëndësh/modulesh që janë në proces doktorature ose që janë me master.
10. Të sigurohet që studentët e këtyre programeve të studimit të japid në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.


II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

1. **Për rekomandimin Në të ardhmen të shihet nga Albanian University mundësia e rritjes së numrit të pedagogëve me kohë të plotë dhe me grada e tituj shkencorë sepse kjo gjë do ta ndihmonte atë të plotësonte standardet lidhur me numrin e pedagogëve me kohë të plotë e të krijonte një profil të plotë të sajin (aktualisht rreth 15% e pedagogëve janë me kohë të plotë për programet MSH Administrim Publik me profile: a) Politika publike dhe BE, b) Politika publike dhe qeverisje, dhe MP Qeverisje dhe Administrim Publik, pra nuk e plotëson këtë standard; problem nga i cili vuajnë shumica dërrmuese e universiteteve private në Shqipëri), **institucioni** ka rritur numrin e pedagogëve me kohë të plotë vetëm vitin e fundit 2018-2019 në raportin 8/5 duke përbërë 62%, të personelit mësimdhënës për programin e studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik", ndëkohë që gjatë periudhës 2012-2017 programi i studimit është mbuluar kryesisht nga personeli akademik i punësuar me**



kontratë. Në periudhën 2012-2017 vetëm 2 pedagogë me kohë të plotë janë angazhuar në këtë program studimi, dhe raporti PAE/PAK për vitin akademik 2017-2018 ka qënë 2/9, 2016-2017 (2/10), 2015-2016 (2/9), 2014-2015 (2/5), 2013-2014 (2/10), 2012-2013 (2/4). 7 nga 8 pedagogët me kohë të plotë të këtij program studimi kanë grada dhe tituj shkencorë

2. **Për rekomandimin** *Biblioteka të pasurohet me libra të autorëve të njohur të vendit dhe të huaj dhe të bëhen abonime në libraritë elektronike të universiteteve të njohura të huaja, institucioni ka* shtuar fondin me 172 tituj të ndryshëm, dhe ky fond pasurohet çdo fillim viti me literaturën e kërkuar nga departamenti për lëndët e programeve të studimit. IAL-ja ofron gjithashtu mundësinë e bibliotekës online QUESTIA, e cila përmban libra akademike dhe artikuj shkencore në gjuhën angleze, të aksesueshme pa pagesë nga studentët dhe stafi akademik.
3. **Për rekomandimin** *Lidhur me Zyrën e Karrierës në AU sugjerohet që t'i jepet hapësirë fizike më e madhe kësaj zyre në mënyrë që t'i kryejë më mirë funksionet e veta, dhe të japë një perceptim më të mirë në këndvështrimin e studentëve dhe palëve të tjera të interesuara, institucioni ka* marrë masa duke i dhënë zyrës së karrierës një sipërfaqje prej 18.13m^2 me vendodhje në Godinën e Arkitekturës dhe Inxhinierive në Rrugën e Kavajës.
4. **Për rekomandimin** *Për programin MP Qeverisje dhe Administrim Publik, të shihet mundësia që në semestrin e fundit të studimeve master të përfshihen të paktën dy lëndë me zgjedhje, praktikë e hasur në shumë universitete të njohura botërore, institucioni ka* përfshirë dy grup lëndësh me zgjedhje në semestrin e dytë (grup lëndë me zgjedhje: lënda "Struktura", "politika dhe institucionet e BE-së", ose lënda "E drejtë kushtetuese e krahasuar"; si dhe lënda "Politika sociale krahasuese", ose lënda "Politikat e personelit dhe menaxhimi i burimeve njerëzore".
5. **Për rekomandimin** *Të bëhet shumë promociion për tërheqjen në këto profile studimi të studentëve të rinj me rezultate të larta nga sistemi i studimeve Bachelor, me qëllim që të investohet shumë tek ata dhe të bëhen në të ardhmen lidera përkatesisht në fushën e administrimit publik, institucioni ka* hasur vështirësi në tërheqjen e studentëve me rezultate të larta nëse i referohemi notës mesatare hyrëse ku për vitin akademik 2017-2018 ka qënë 6.71, dhe ka ardhur në rënien krahasuar me vitet paraardhëse, në vitin akademik 2012-2013 nota mesatare hyrëse ka qënë 7.26.
6. **Për rekomandimin** *Duhet vënë theksi në përmirësimin dhe azhornimin e vazhdueshëm të programeve të këtyre profileve duke u bazuar në literaturat më bashkëkohore dhe të autorëve të njohur të vendit dhe botërorë, institucioni ka* ngritur grupe pune të cilët kanë pasur si detyrë rishikimin e programeve në tërsine e tyre, me qëllim përmiresimin dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës dhe standardet e cilësisë, sikurse dhe me praktikat dhe modelet bashkëkohore te ndjekura nga universitetet perendimore. Ky proces është finalizuar me riorganizimin dhe përmirësimin e programeve, në përputhje me praktikat më të mira por edhe bazen ligjore në fuqi.
7. **Për rekomandimin** *Të gjendet mënyra që lënda/syllabusi Acquis Communitaire të emërtohet në gjuhën shqipe, meqë PS zhvillohet në gjuhën shqipe, nuk aplikohet për këtë program studimi*
8. **Për rekomandimin** *Biblioteka të mylllet e të izolohet nga zhurmat, të zgjerohet e të përshtatet për t'i krijuar më shumë komoditet të interesuarve për përdorimin e bibliotekës në AU, institucioni ka* siguruar një ambjent me sipërfaqje 248.6 m^2 , të përshtatshëm i cili ofron një mjedis të qetë dhe komod për të studiuar.
9. **Për rekomandimin** *Lidhur me plotësimin e kriterit 2 të standardit III.2, konstatohet se janë katër titullarë lëndësh/modulesh që janë në proces doktorature ose që janë me master, institucioni ka*



siguruar që stafi i angazhuar në mësimdhënien të jetë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Aktualisht, 7 nga 8 pedagogët me kohë të plotë të këtij program studimi kanë grada dhe tituj shkencorë.

10. Për rekomandimin *Të sigurohet që studentët e këtyre programeve të studimit të japid në përfundim dhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare, institucioni ka zbatuar legjislacionin në fuqi ku njohja e një gjuhe të huaj nuk është kusht për pranimin/përfundimin e programeve të studimit master profesional*

Konkluzion përmbragjave e rekomandimeve nga akreditimi i parë në tërësi.

Institucioni i ka plotësuar në tërësi 8 rekomandimet e Këshillit të Akreditimit. Ndërkohë rekomandimi i 1-rë dhe i 5-të nuk janë plotësuar.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjite afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Ky program studimi ofrohet në përputhje me misionin, qëllimin dhe strategjinë e zhvillimit të Institucionit. Ai është hartuar në përputhje me zhvillimet ekonomike të vendit dhe objektivat kombëtare dhe ndërkombëtare. Sipas Strategjisë për Zhvillimin Institucional 2017-2022, organizimi institucional; mësimdhënia, kurrikula dhe mësimnxënia; kërkimi shkencor; veprimtaria shërbyses; dhe marrëdhënet me jashtë janë pesë objektivat strategjike bazë të Universitetit privat Albanian University, nëpërmjet të cilave Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative bazohet për të ofruar një trajnim akademik të avancuar në nivelin Master Profesional, me një fokus të veçantë në njohuritë dhe aftësitë e avancuara profesionale.

Misioni i Programit të studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" është pajisja e studentëve të diplomuar me njohuri baze mbi teoritë e shkencave administrative, procedurat, politikat, institucionet vendore dhe qeverisjen e tyre. Ky program studimi synon të kontribuojë në rritjen e cilësisë profesionale të të diplomuarve të ciklit të parë të studimeve apo të profesionistëve të cilët duan të vazhdojnë më tej karrierën profesionale duke u specializuar në fushën e administrimit publik dhe qeverisjes. Një vembje e veçantë i kushtohet dimensionit dhe njohjes së institucioneve, strukturave dhe legjislacionit kombëtar, dhe si i tillë nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat kulturore kombëtare. Pjesë e objektivave formuese të këtij programi studimi janë edhe njohja me sistemet politike, konceptet bashkëkohore të financat publike, komunikimit, qeverisjes vendore, gërshtetimi i teorisë me praktikën si dhe njohja e funksionimit të administratës publike. Qëllimi final i këtij programi studimi është përgatitja dhe angazhimi i specialistëve të administratës në funksion të mbarëvajtjes së shtetit. Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të


fitojnë studentët në përfundim të këtij programi. Ky program mundëson aplikimin në praktikë të njojurive dhe aftësive të fituara në orët teorike për arsyet e karakterit të mirëfilltë profesional të tij dhe njojurive nga fushat ekonomiko shoqërore duke synuar në përgatitjen dhe kualifikimin e mëtejshëm të studentëve për punësim në të ardhmen.

Ky program studimi i profilizon studentët në drejtime të ndryshme të administrimit publik, duke i ofruar njojuri mbi metodat matëse sasiore të zhvilluara mbi përmirësimin e administratës publike, mbi modelet dhe vizonet bashkëkohore dhe mbi pozicionimin e administratës publike në kontekstin e globalizimit dhe integrimit evropian. Programi gjithashtu stimulon aftësitë praktike për analiza sistemike, në çështje kombëtare dhe rajonale nën raportin e standardeve dhe rregullave të testimit empirik të profilit. Të diplomuarit e këtij programi pajisen me aftësi për konstruksione logjike me bazë teorike, kompetenca argumentuese dhe këshilluese për institucionet që mbulojnë marrëdhëniet e administratës me publikun të interesuara në këto specialitete.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Misioni i programit të studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" është konceptuar dhe zhvilluar në përputhje me misionin dhe qëllimin e përgjithshëm të institucionit; sic përcaktohet në Statutin dhe strategjinë 2017-2022 të IAL-së dhe në Planin Strategik të Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative 2017-2022.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Programi i studimit Master Profesional në Qeverisje dhe Administrim Publik, bazuar në aktet normative të IAL-së, synon përgatitjen dhe kualifikimin e individuve në fushën e administrimit, dhe të qeverisjes ne përputhje me standarde bashkëkohore evropiane dhe ndërkombëtare.
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	Programi i studimit është hartuar duke iu referuar nevojave të tregut të punës dhe kërkesës për ekspertë me njojuri të avancuara dhe specifike në qeverisje dhe administrim të politikave si në sektorin publik dhe atë privat, pavarësisht se sektori publik është një ndër sektorët me kërkesën me të lartë për të diplomuarit në këtë program studimi.
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	Për të qënë sa më afër tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik të vendit programi i

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupei duhet të japë mendimin e tij për përbushjen e standardeve në tërësi.




	<p>studimit rishikohet periodikisht nga departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave.</p> <p>Ky program studimi i kushton një vëmendje të veçantë dimensionit kombëtar dhe njohjes së strukturave, institucioneve, legjislativit dhe funksionimit të administratës kombëtare.</p> <p>Si i tillë, ky program studimi është në përputhje të plotë me vlerat kulturore të Republikës së Shqipërisë dhe interesat kombëtare të krijimit të qytetarëve të denjë dhe të efektshëm në ndryshimet themelore demokratike të shoqërisë. Gjithashtu ky program studimi është në përputhje edhe me etikën profesionale dhe atë civile.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit i ofruar nga Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, është hartuar në përputhje me strategjinë për zhvillim të Institucionit dhe strategjinë e departamentit dhe planin e masave.</p> <p>Programi i studimit është në përputhje me misionin dhe objektivin kryesor të departamentit për angazhimin dhe përgatitjen e studentëve në sfidën e përbashkët të thellimit të dijeve, për përgatitjen e një gjenerate studiuesish në sferën e shkencave politike dhe administrative.</p> <p>Për arritjen e këtij misioni, Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative realizon procesin e mësimdhënies, kërkimin shkencor si dhe ofrimin e shërbimeve komunitare në kuadër të përmbushjes së përgjegjesisë sociale.</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit të IAL dhe takimet me titullarët e institucionit, konstatojmë se në hartimin e programit janë marrë parasysh kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” si program i ciklit të dytë të studimeve ka një ngarkesë prej 60 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje normale studimi prej 1 viti.</p> <p>Emërtimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me nivelin e 7 të kualifikimit të përcaktuar nga “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve”, e përshtatshme për të mundësuar njohuri të specializuara, kritike dhe bashkëkohore, praktikë profesionale dhe qasje të reja në fushën e qeverisjes dhe administrimit</p>

	<p>publik. Ky program synon gjithashtu, aftësimin për të integruar njohuritë nga fusha të tjera në fushën e qeverisje dhe administrimit publik, si dhe ofron kompetenca për studentët që të jenë në gjendje të administrojnë procese dhe institucionë.</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënëtit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucional për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucional për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënëtit.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit të IAL-së dhe takimet me titullarët e institucionit, konstatojmë se institucioni ka hartuar një plan strategjik 2017-2022 në nivel institucional si dhe një Planin Strategjik të Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative, të cilët përcaktojnë drejtimet kryesore për zhvillimin e institucionit dhe programeve të studimit sipas standardeve bashkëkohore evropiane dhe ndërkombëtare.</p> <p>Në planin e tij strategjik departamenti parashikon impenjim në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm dhe të konsolidimit të programeve mësimore përmes përmirësimit të kurrikulës, mësimdhënies dhe mësimnxënjes, përmirësimit të angazhimit të studentëve në kërkimin shkencor, përmirësimin e ofrimit të praktikave profesionale për studentët, si dhe transferimit të njohurive përtrej komunitetit të IAL-së. Kjo e fundit edhe nëpërmjet ndërveprimit gjithnjë e më të madh me institucionë të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Plani strategjik institucional synon gjithashtu të sjellë inovacione në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor, përmirësim të mësimdhënies dhe të rezultateve të nxënësve. Nëpërmjet Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në bashkëpunim me grupet e sigurimit të cilësisë në nivel njësie bazë, synohet të arrihet sigurimi i ekselencës në mësimdhënie dhe mësimnxënje.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

Programi i studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik”

1. është hartuar në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe nivelin e përcaktuar nga “Korniza Shqiptare e Kualifikimeve”
2. është hartuar dhe zhvilluar në përputhje me misionin dhe qëllimin e përgjithshëm të institucionit të përcaktuara në statutin, strategjinë (2017-2022) e IAL-së, si dhe në planin strategjik të departamentit.
3. i përshtatet tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik të vendit duke i kushtuar një vëmendje të veçantë dimensionit kombëtar



2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënieve së informacionit

Fakulteti i Shkencave Shoqërore është njësi kryesore e IAL-së e cila organizon dhe drejton mësimdhënien dhe kërkimin shkencor. Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga autoritetet drejtuese, organet drejtuese, dhe departamentet si njësitë bazë mësimore shkencore.

Fakulteti i Shkencave Shoqërore përbëhet nga 4 departamente

- 1. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative;**
- 2. Departamenti i Shkencave Juridike;**
- 3. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme;**
- 4. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtes;**

Personeli Akademik përbëhet nga profesore, lektore dhe asistent-lektorë më kohë të plotë, me kontratë, si dhe personel akademik i ftuar. Personeli akademik angazhohet në mësimdhënie dhe kërkim shkencor por ai mund të angazhohet edhe me punë të tjera të natyrës administrative. Detyrat dhe të drejtat e stafit akademik përcaktohen në kontratën e punës.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Shkencave Shoqërore, përbëhet nga 4 njësi bazë (Departamente);

- 1. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative;**
- 2. Departamenti i Shkencave Juridike;**
- 3. Departamenti i Psikologjisë së Përgjithshme;**
- 4. Departamenti i Edukimit dhe Anglishtës;**

Fakulteti në vitin aktual akademik **2018-2019** ka në përbërjen e tij **111** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **39** persona, nga të cilët **28** janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej **72**, nga të cilët **52** me tituj/grada. (Sipas Tab nr.1 RVB)

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative ka aktualisht në përbërjen e tij (viti akademik 2018-2019), **24** anëtarë prej të cilëve **8** janë **Personel Akademik Efektiv (PAE)** dhe **16** janë **Personel Akademik me Kontratë (PAK)**. Nga personeli akademik efektiv (PAE) 6 anëtarë janë me tituj dhe grada, ndërsa nga personeli akademik me kontratë (PAK) 11 anëtarë janë me tituj dhe grada, Në total **17** nga **24** anëtarë të departamentit janë me tituj dhe grada shkencore.



Personeli Administrativ (PA) që është në funksion të departamentit përbëhet nga 3 anëtarë (me gradën MSc) si dhe 6 anëtarë për të gjithë fakultetin (Administratori, kryesekretari, punonjësi i bibliotekës, fotokopjes dhe 2 IT).

Në nivel program studimi, Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik", raporti personel akademik efektiv dhe ai me kontratë PAE / PAK, për vitin akademik **2018-2019** është **8/5.**

Në vitet e mëparshme akademike raportet PAE/PAK të departamentit të Shkencave Politiko-Administrative kanë qënë si më poshtë:

Për vitin akademik 2017-2018 (7 / 14) nga këta pa grada shkencore 2 / 8;

Për vitin akademik 2016-2017 (7 / 12) nga këta pa grada shkencore 1 / 7;


Për vitin akademik 2015-2016 (12 / 13) nga këta pa grada shkencore 6 / 7;

Për vitin akademik 2014-2015 (11 / 29) nga këta pa grada shkencore 5 / 20;


Për vitin akademik 2013-2014 (11 / 51) nga këta pa grada shkencore 11 / 35;

Për vitin akademik 2012-2013 (10 / 41) nga këta pa grada shkencore 7 / 31.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përbushjen e misionit të tij. <p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tillë, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Institut i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimi me titullarë të institucionit konstatojmë se struktura organizative e institucionit është në përbushje të kërkesave të legjislativit në fuqi dhe i përgjigjet objektivave të përcaktuara në misionin e IAL-së</p> <p>Albanian University, pas riorganizimit të kryer me Urdhër Nr.52, datë 5.02.2016 të MAS, përbëhet nga tre njësi kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fakulteti i Shkencave Shoqërore; • Fakulteti i Shkencave të Aplikuara dhe Ekonomike • Fakulteti i Shkencave Mjekësore <p>Çdo fakultet ka, së paku, 3 departamente si njësi bazë.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Shoqërore, përbëhet nga 4 njësi bazë (Departamente), përfshirë Departamentin e Shkencave Politiko-Administrative përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik".</p> <p>Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative ka në përbërjen e tij 8 pedagogë efektivë (PAE) nga të cilët, 6 me tituj dhe grada</p>



	shkencor (1 anëtar ka titullin shkencor Profesor dhe 5 anëtarë të tjerë kanë gradën shkencore Doktor.
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
	<p>Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për realizimin e programit të studimit përcaktohen në Statut (neni 16), dhe detajohen në rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit.</p> <p>Ndër përgjegjësitë kryesore të departamentit për realizimin e programit të studimit përmendim programimin, bashkërendimin, zhvillimin, organizimin dhe administrimin e veprimtarisë së mësimdhënieς dhe asaj kërkimore-shkencore për programin e studimit që ofron, si dhe përcaktimin e kritereve të pranimit të studentëve.</p>
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Njësia bazë dhe ajo kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij. Bazuar në nevojat për personel akademik njësitë bazë i paraqesin Dekanit kërkesën për plotësimin e vendeve vakante. Vendet vakante publikohen në faqen zyrtare të Institucionit, buletinin e zyrave të punësimit dhe televizionin UTV.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit i propozon Dekanit kriteret e posaçme të pranimit si dhe listën me emrat e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve, pas diskutimit paraprak në departament. Përgjegjësi i departamentit, bën vlerësimin e performancës së personelit akademik të departamentit nëpërmjet formularit të vlerësimit ku përfshihen pjesëmarrja në konferanca dhe trajnime, realizimi i botimeve shkencore, korrekëtësia në çështje administrative dhe realizimin e orëve mësimore, si dhe marrëdhënia me studentin.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimi me titullarë të institucionit konstatojmë se:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Albanian University është në përbushje të kërkesave të legjisacionit në fuqi dhe i përgjigjet objektivave të përcaktuara në misionin e IAL-së. 2. Albanian University ka 3 Fakultete, ku çdo fakultet ka së paku, 3 departamente si njësi bazë; 3. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative ka 8 anëtarë efektivë (PAE) si personel akademik, 6 prej tyre me tituj dhe grada shkencor; 4. Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative është përgjegjësitet për realizimin e programit të studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik", si dhe i përfshirë drejtpërsëdrejti në procesin e rekrutimit dhe vlerësimit të personelit akademik të angazhuar në këtë program 	



3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik i Departamentit kryen veprimtari të mësimdhënies, kërkimit-shkencor dhe shërbime në përputhje me detyrat e përcaktuara dhe të rregulluara me Kontratën Individuale të Punës. Mësimdhënia ndër vite në këtë program studimi është mbuluar kryesisht nga pedagogë të jashtëm, dhe vetëm 2 pedagogë të Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative, përjashtim bën viti i fundit 2018-2019 (8 pedagogë, 7 prej të cilëve kanë grada dhe tituj shkencorë).

Në nivel program studimi, Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik", rapporti personel akademik efektiv dhe ai me kontratë është përmirësuar në funksion të shtimit të numrit të pedagogëve të angazhuar *por me kontratë*, përjashtim bën viti i fundit.

Të dhëna mbi numrin e stafit të angazhuar ndër vite për këtë program studimi janë si më poshtë:

Për vitin akademik **2018-2019** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ishte **13** pedagogë gjithsej, nga te cilet **8** ishin PAE, **7** me tituj/grada dhe **5** PAK, **4** me tituj/grada.

Për vitin akademik **2017-2018** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **11** pedagogë gjithsej, nga te cilet **2** kanë qenë PAE, **1** me tituj/grada dhe **9** PAK, **6** me tituj/grada.

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **12** pedagogë gjithsej, nga te cilet **2** kanë qenë PAE, **2** me tituj/grada dhe **10** PAK, **6** me tituj/grada.

Për vitin akademik **2015-2016** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **11** pedagogë gjithsej, nga te cilet **2** kanë qenë PAE, **1** me tituj/grada dhe **9** PAK, **5** me tituj/grada.

Për vitin akademik **2014-2015** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **7** pedagogë gjithsej, nga te cilet **2** kanë qenë PAE, **1** me tituj/grada dhe **5** PAK, **1** me tituj/grada.

Për vitin akademik **2013-2014** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **12** pedagogë gjithsej, nga te cilet **2** kanë qenë PAE, **2** me tituj/grada dhe **10** PAK, **5** me tituj/grada.


Për vitin akademik **2012-2013** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **6** pedagogë gjithsej, nga te cilet **2** kanë qenë PAE, **2** me tituj/grada dhe **4** PAK, **3** me tituj/grada.

Personeli administrativ i angazhuar për mbarëvajtjen e këij programi studimi përbëhet nga **7** anëtarë.

Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi zotëron kualifikime të ndryshme për specialitetin e lëndës që ofron, si dhe vijnë nga një përvjose e gjatë profesionale në fushën e mesimdhënies, ose në drejtimet profesionale që ata përfaqësojnë. Ngarkesa e orëve mësimore e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi nuk i kalon 120 orë për pedagog (viti akademik 2018-2019).

Raporti Personel Akademik / Student në këtë program për vitin akademik aktual është **13/28**

Raporti Personel Administrativ / Student në këtë program për vitin akademik aktual është **7/28**



Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre

Personeli akademik mësimdhënës ka tituj dhe grada shkencore dhe ky raport ka ardhur në rritje. Aktualisht ka 2 pedagogë me tituj shkencorë (Prof dhe Prof. As.), 9 pedagoë me gradë shkencore (Dr./PHD), dhe vetëm 2 pedagogë me MSc. ose në proces doktorature.

Të dhënat sipas seksit

Për vitin akademik 2018 – 2019 raporti meshkuj/femra për këtë program studimi është 6/7.

Të dhëna sipas moshës së personelit

Personeli Akademik Efektiv përbëhet nga personel i grup moshës **36-45 vjecare**.

Personeli Akademik me Kontratë përbëhet nga personel i grup moshës **36-55 vjecare**.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative i cili është edhe përgjegjës për programin e studimit, ndërmerr një politikë të qartë në lidhje me angazhimin e një stafi akademik i cili mbart eksperiencë në fushën profesionale. Takimi me Përgjegjësen e Departamentit theksoi synimin e institucionit për përbushjen e kërkeseve me staf akademik me kohë të plotë. Kërkesa për staf akademik dhe personel ndihmës-mesimor buron nga departamenti. Të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit akademik jepen në Kontraten e Punës e hartuar mbi bazën e Kodit të Punës dhe akteve ligjore në fuqi. Institucioni i kushton një vemendje të veçantë hartimit të kontratës për stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme. Kontratat administrohen nga zyra e Burimeve Njerëzore e cila është përgjegjëse jo vetëm për arkivimin e dokumentacionit dhe ruajtjen e tij në vite, por edhe për gjenerimin e statistikave vjetore. Çdo fillim viti akademik/seimestër zyra e burimeve njerëzore bën përditësimin e informacionit mbi stafin akademik.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Stafi administrativ në nivel departamenti ka 7 anëtarë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	



Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimorshkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe përrritjen e tyre;	Personeli akademik dhe administrativ është i informuar dhe i angazhuar për realizimin e objektivave të programit të studimit dhe strategjinë e zhvillimit të departamentit, përmes dokumetacionit rregulator, raporteve semestrale dhe vjetore si dhe mbledhjeve të departamentit.
Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimorshkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	Performanca e angazhimit vlerësohet nga vlerësimet e Përgjegjësit të Departamentit dhe mbledhjet e departamentit, në të cilat diskutohet dhe bëhen rekomandime për përmirësimë të nevojshme në arritjen e objektivave dhe realizimit të strategjisë së departamentit.


Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.

Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	Personeli akademik i Departamentit luan një rol kryesor në hartimin, zhvillimin, dhe përditësimin e kurrikulës. Çdo fillim viti stafi akademik angazhohet ne rishikimin e kurrikulës në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe nevojat e studentëve dhe institucionit.
Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	Në rekrutimin e personelit akademik merren në konsideratë kërkesat ligjore dhe përcaktimet në rregulloren e departamentit. Në këtë program studimi janë angazhuar pedagogë me grada dhe tituj, përvèç 2 pedagogëve të cilët janë me Msc ose në proces doktorature. Ngarkesa mësimore e pedagogëve është brenda normave.


Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	Departamenti në fillim të çdo viti akademik, bazuar në nevojat për personel akademik, i paraqet Dekanit të Fakultetit kërkesat për plotësimin e vendeve vakante, përcakton kriteret e pranimit, procedurën e konkurrimit si dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të kandidatëve, pas diskutimit paraprak në departament. Vendet e punës për personelin akademik publikohen në faqen zyrtare dhe mjete të tjera të komunikimit të institucionit.
Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruar të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;	Personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit, gjatë periudhës 2012-2017 është mbuluar kryesisht nga personeli akademik i punësuar me kontratë (PAK), vetëm 2 personel akademik efektiv(PAE), janë angazhuar në këtë program studimi).
Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	Në vitin akademik 2018-2019 personeli akademik efektiv (PAE) i angazhuar në programin e studimit është rritur ndjeshëm në raportin 8/5 duke përbërë 62% të personelit akademik në total.
Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve përvende vakante, etj.	Në lidhje me ngarkesën e orëve mësimore përvitin akademik 2018-2019, PAE realizon 57% të orëve në auditor (397 nga 702 orë). Ngarkesa në orë për PAE ka qënë disi e ulët edhe për natyrën që ka ky

	<p>program studimi i cili përfshin lëndë me karakter juridik, ekonomik dhe politik.</p> <p>IAL-ja ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit akademik, duke përdorur disa mekanizma: si formularët e vlerësimit nga përgjegjësi i departamentit ku përfshihen pjesëmarrja në konferanca dhe trajnime, realizimi i botimeve shkencore, korrektësia në çështje administrative dhe realizimin e orëve mësimore, si dhe marrëdhënia me studentin; pyetësori dhe fokus grupet me studentët në fund të çdo semestri me mbështetjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p>Institucioni mban baza të të dhënave të njoftimeve për vende vakante, të procedurave të rekrutimit të personelit, të emërimit të Komisioninit të Vlerësimit të kandidaturave.</p> <p>Zyra e burimeve njerëzore mban gjithë dokumentacionin e personelit akademik, megjithatë nga takimi në zyrën e burimeve njerëzore u konstatua edhe një rast ku mungonte dëshmia e njehsimit të tituve të fituar jashtë vendit.</p>
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asocuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;	Përgjegjësi i departamentit është njëkohësisht edhe përgjegjës i programit të studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik". Ajo ka gradën shkencore "Doktor i Shkencave" të përfshuar nga Universiteti i Tiranës
Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";	Titullarët e lëndëve në programin Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" kanë të paktën gradën shkencore "Doktor" dhe përvojë profesionale në institucione publike dhe/ose në fushën e mësimdhënies.
Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Professional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;	Titullarët e institucionit dhe përgjegjësat e zyrave të shërbimit janë të punësuar me kohë të plotë pranë IAL-së.
Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;	IAL-ja siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale. Raporti pedagogë/studentë për programin e studimit është i ulët, çka siguron personel akademik të mjaftueshëm për udhëheqje dhe mbikëqyrje të praktikave profesionale. Gjithashtu, departamenti ka ngarkuar një pedagog, i cili ndjek dhe mbikqyr praktikat profesionale
Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.	
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezin.	



<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimore të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Studentet e programit të studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" në përfundim të studimeve të tyre dorëzojnë mikrotezë në një fushë kërkimore të propozuar nga ta dhe të udhëhequr nga personeli akademik i disiplinës përkatëse deri në momentin e mbrojtjes përpara komisionit të vlerësimit.</p> <p>Stafi akademik i përcaktuar nga departamenti për të udhëhequr studentet në përgatitjen e mikrotezës kanë të paktën gradën shkencore "Doktor".</p> <p>Numri i studenteve që udhëheq njëkohësisht një pedagog për temat e ofruara nga Departamenti është jo me shume se 7 (13 pedagogë për 28 studentë).</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njojuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohtet teza.</p>	<p>Udhëheqësit e mikrotezës kanë ekspertizë dhe specializimin e duhur për fushat në të cilat udhëheqin punën kërkimore.</p> <p>Ata kanë kontributë profesionale dhe aktivitete kërkimore në fushën e parashikuar për mikrotezen</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe përmirëbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni ka një strukturë dhe personel të kualifikuar për të përbushur objektivat e programit të studimit dhe për të mbështetur aktivitetet mësimore dhe kërkimore.</p> <p>Departamenti angazhon staf ndihmës për organizimin e programit të studimit dhe për realizimin e orëve të praktikës.</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në kontratën e punës dhe sipas aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programin e studimit Master profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik", vlerësohen me orë mësimore, dhe stafi i angazhuar në këtë program studimi ka një ngarkesë mesatarish 46 orë mësimore dhe vetëm në një rast arrin 120 orë mësimore.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	



<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>IAL-ja disponon bazë të dhënash të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik dhe administrative në departamentet përkatës dhe zyrën e burimeve njerëzore, të cilat përditësohen të paktën një here në vit. Këto të dhëna përfshijnë gradat dhe titujt, CV-të, kontratat, ngarkesën dhe detyrat që kryejnë, si dhe dokumentacionin ligjorë të nevojshëm për punësim.</p> <p>Gjithashtu, IAL-ja disponon listën e plotë të personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrative, për secilin semester.</p> <p>IAL-ja publikon vendet vakante dhe kriteret e punësimit për cdo pozicion pune vakant në faqen e institucionit dhe mjete e tjera të komunikimit.</p>
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimi me titullarë të institucionit konstatojmë se:

1. Në përbushje të objektivave të programit të studimit janë të angazhuar si personeli akademik, ashtu edhe ai administrativ i cili luan një rol kyç në hartimin, zhvillimin, dhe përditësimin e kurrikulës;
2. Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;
3. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi është me grada shkencore dhe tituj akademikë, megjithatë personeli i punësuar me kohë të plotë i angazhuar për realizimin e programit të studimit vetëm vitin e fundit mbulon nevojat e programit në masën **62%**, ndërsa përsa i përket ngarkesës mësimore të realizuar, ajo mbulohet në masën **57%** nga personeli akademik efektiv (PAE);
4. Ngarkesa mësimore është e përcaktuar në kontratë dhe e shprehur në orë mësimore të cilat nuk i kalojnë 120 orë për këtë program studimi;
5. Studentët e këtij programi studimi kanë një udhëheqës të specializuar për mikromës i diplomës i cili është në përputhje me fushën studimore;
6. Institucioni mban një bazë të dhënash të personelit dhe disponon listën e plotë të personelit akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ për secilin semestër.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjiet e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, së bashku me tre Departamentet e tjera të Fakultetit të Shkencave Shoqërore, e zhvillon procesin akademik, në godinën qëndrore të IAL-së, me një sipërfaqe totale prej 3996 m². Godina ekzistuese dhe ambientet e saj janë rikonstruktuar dhe adaptuar në klasa dhe laboratorë për zhvillimin e procesit mësimor, duke plotësuar edhe kërkesat e seclilit departament për të ofruar programet respektive të studimit. Infrastruktura e IAL-së përmban klasa më hapësira të mëdha me sistem kondicionimi ngrohje-ftohje, laboratorë të pajisur me mjetet e

nevojshme teknologjike, përfshirë kompjutera, video projektorë, ekrane të mëdha etj. Zyra për përgjegjësin e departamentit, dhe zyrat e shërbimeve të tjera ishin të mjaftueshme, si nga numri ashtu edhe nga sipërfaqja, dhe me kushte bashkëkohore.

IAL-ja ka një Bibliotekë të pajisur me tituj librash specifikë për programin e studimit (aktualisht fondi i bibliotekës numëron rreth 172 tituj të ndryshëm), dhe ky fond pasurohet çdo fillim viti me literaturën e kërkuar nga departamenti për lëndët e programeve të studimit. IAL-ja ofron gjithashtu mundësinë e bibliotekës online QUESTIA, e cila përmban libra akademike dhe artikuj shkencore në gjuhën angleze, të aksesueshme pa pagesë nga studentët dhe stafi akademik.

OPTIME është revista shkencore e institucionit në të cilën botahen punime shkencore të stafit akademik. Albanian University Press - është shtëpia botuese e IAL-së, e cila boton tekstet mësimore dhe studime të pedagogëve në ndihmë të zhvillimit të kurrikulave dhe specifikës së programeve të studimit.


Rrjeti i kompjuterik që përdoret nga studentët, stafi akademik dhe punonjësit e administratës është funksional dhe ofron shërbim interneti pa limit. IAL-ja ka website-in e tij zyrtar e cila është e përditësuar dhe ka informacionin e nevojshëm për studentët dhe të interesuarit e tjerë. Infrastruktura e IAL-së ofron edhe shërbime të tjera ndihmëse si shërbimi i fotokopjes që mund të përdoret nga studentët dhe pedagogët. Salla e Konferencave e pajisur me teknologji multimediale, audio dhe video, për realizimin e konferencave të koordinuara me sistemin e qëndrës së zërit dhe qëndrën e përkthimit simultan, për aktivitete ekstra-kurrikulare (simpoziume, konferanca, seminare, leksione të hapura shkencore e workshope). Kanali televiziv UTV është një tjetër shërbim i infrastrukturës së IAL-së.

IAL-ja ka edhe mjedise shplodhëse (cafeteria, fast-food, dhe vetëshërbimi ushqimor) për të gjithë studentët. Në hyrje të godinës ekziston zyra e informacionit dhe recepcionit për cdo informacion nga të interesuarit. Ndërtesa është e pajisur me sistem kamerash vëzhguese në mjediset e jashtme dhe të gjitha hollët e kateve, të cilat janë të monitoruara gjatë 24 orëve me roje private.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

• Salla për leksione	10 me sipërfaqje 1,120.2 m ²
• Klasa për seminare	20 me sipërfaqje 1,005 m ²
• Salla për aktivitete promovuese	1 me sipërfaqje 245 m ²
• Salla për praktikë lëndore/ profesionale	Nuk Ka
• Laboratorë informatike	1 me sipërfaqje 35 m ²
• Salla interneti	Nuk Ka
• Salla për bibliotekë	1 me sipërfaqje 248.6 m ²
• Mjedis për fotokopjime, librari etj.	1 me sipërfaqje 7 m ²
• Zyrë informacioni për studentët	1 me sipërfaqje 6 m ²
• Korridore/holle	11 me sipërfaqje +645 m ²
• Mjedise sportive	Nuk Ka



• Mjedise shërbimi për të tretë	2 me sipërfaqje 567 m²
• Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	1 me sipërfaqje 16 m²
• Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etc.	2 me sipërfaqje 567 m²
• Nyje hidrosanitare për studentët	6 me sipërfaqje 106.4 m²

Mjediset për stafin:

• Zyra për Dekanin	1 me sipërfaqje 9 m²
• Zyra për Departamentin	1 me sipërfaqje 30.3 m²
• Zyra për sekretarinë mësimore	2 me sipërfaqje 40 m²
• Zyra për personelin akademik të departamentit	1 me sipërfaqje 21.3 m²
• Zyrë për financën	2 me sipërfaqje 47 m²
• Zyrë për Njësinë e SBC dhe Zyra e Kurrikulave	1 me sipërfaqje 23.2 m²
• Zyrë për Koordinimin dhe Mbështetjen ndaj Studentëve	1 me sipërfaqje 18.13 m²
• Zyrë për IT	1 me sipërfaqje 20 m²
• Nyje hidrosanitare për personelin akademik	2 me sipërfaqje 6.4 m²

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruaratë studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	IAL-ja ka një vendndodhje të përhershme në qendër të qytetit, me kampusin qëndror (Bulevardi "Zogu I") zyra akademike dhe ambjente ku zhvillohet procesi mësimor i programit të studimit, dhe me disa zyra administrative, përfshirë burimet njerëzore te rruga e Kavajës.
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Këto mjedise kanë qenë në dispozicion të institucionit me kontrata të përsëritura që prej vitit 2006.
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizmin e programeve të studimeve që ofron;	Programi i studimit zhvillohet i gjithi në godinën qëndrore.
Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	Institucioni, gjithashtu ka një shfrytëzim optimal të infrastrukturës në dispozicion, pasi mësimi në ciklin e dytë të studimeve zhvillohet mbasdite gjatë ditëve të javës si dhe ditën e shtunë.
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;	IAL-ja siguron tekstet mësimore falë edhe shtëpisë botuese të sajën si me literaturë cilësore bashkëkohore të përkthyer ashtu edhe me literaturë ndihmëse të pedagogëve të IAL-së.
Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e	



<p>ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Literatura bazë e paraqitur në cdo syllabus gjendet në bibliotekën e IAL-së dhe është e mjaftueshme për realizimin e procesit mësimor, si dhe për të realizuar detyra kursi dhe përgatitjen e temës së diplomës.</p> <p>IAL-ja ka revistën e saj shkencore, OPTIME, në të cilën botaohen punime shkencore të të gjithë stafit akademik. IAL-ja ofron gjithashtu mundësinë e bibliotekës online QUESTIA, e cila përmban libra akademike dhe revista shkencore në gjuhën angleze, të aksesueshme pa pagesë nga studentët dhe stafi akademik.</p> <p>Institucioni çdo vit planifikon fond të veçantë për blerjen e literaturës së specjalizuar për çdo program studimi. Çdo fillim viti departamenti bën kërkesë për të pasuruar fondin e bibliotekës me literaturën e përshtatshme për programet e studimit, nisur nga syllabuset.</p> <p>Biblioteka punon nga ora 8.00 deri në orën 16.00, si orar zyrtar i shpallur edhe në mjediset e saj, orar jo i përshtatshëm për programin e studimit Master profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" i cili zhvillohet pasdite. Megjithatë Biblioteka ka edhe orare ekstra për periudha të veçanta si atë të sezonit të provimeve, si dhe Biblioteka online eshtë e aksesueshme 24 nga çdo ambjent për shkat se studentët kanë kod logimi.</p>
---	---

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Infrastruktura e IAL-së është e mjaftueshme si nga numri ashtu edhe nga sipërfaqja, si për sa i përket zyrave për stafin dhe sallave për leksione dhe seminare, si dhe ambjentet janë me kushte bashkëkohore.</p> <p>Mjediset janë të pajisur me mjetet e nevojshme teknologjike, përfshirë kompjutera, video projektorë, ekrane të mëdha, flipcharter për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve.</p> <p>Ambjentet kanë të gjitha pajisjet kompjuterike multimediale në shërbim të leksioneve dhe seminareve.</p> <p>Gjithashtu, në funksion procesit mësimor Fakulteti i Shkencave Shoqërore ka në dispozicion edhe laboratorin e Informatikës, për zhvillimin e orëve mësimore, me një punojnës IT-je për të ofruar shërbimet e nevojshme.</p> <p>Ky program studimi nuk parashikon praktika laboratorike</p>
---	---



Konkluzionet e vlerësimit:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe takimi me titullarë të institucionit konstatojmë se:

1. IAL-ja ka një vendndodhje të përherershme në qendër të qytetit, që prej vitit 2006, dhe infrastruktura e institucionit ka hapësirat e nevojshme dhe komode për zhvillimin e veprimtarisë mësimore;
2. IAL-ja vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësi, si në bibliotekën e IAL-së dhe atë online;
3. Institucioni ka në dispozicion pajisje ndihmëse si video projektorë, ekrane të mëdha, flipcharter për zhvillimin e leksioneve dhe seminareve, si dhe një laborator multimedial

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhue.

Burimet e financimit bazohen kryesisht tek tarifa e shkollimit (rreth 97%) dhe një kontribut tjetër i burimeve financiare lidhet me aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bar, residenca) në masën 3%. Burimet financiare të IAL-së nga tarifat e shkollimit kanë pësuar një rrënie prej 50% krahasuar me të ardhurat e 6 viteve më parë. Rreth 1/3 e burimeve të të ardhurave shpenzohet për qeranë e objektit dhe shërbime të lidhura me mirëmbajtjen, pastrimin, ngrohjen-ftohjen, etj. Pjesa tjetër e burimeve të të ardhurave shpenzohet për pagesat dhe sigurimet e punonjësve të brendshëm dhe të jashtëm, si dhe për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me reklamën, shërbimin e internetit, pajisjet e aparaturat, mjetet e konsumit dhe detyrimet ndaj shtetit. IAL-ja ka një njësi të brendshme e cila menaxhon dhe kontrollon burimet financiare si dhe raporte financiare vjetore të hartuara dhe certifikuara nga ekspertë të jashtëm.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):

• Grantet për kërkim	0%
• Konsulencat, shërbimet	0%
• Tarifat për dhe gjatë shkollimit	97%
• Sponsorizimet	0%
• Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)	0%
• Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj	0%
• Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	3%

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Kostoja për një student në këtë program studimi përllogaritet në vlerën **800 euro për vit akademik**, duke konsideruar shpenzimet për pagat, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore,



honoraret në mësimdhënje, veprimtaritë shkencore, fondin e ekselencës dhe kosto të tjera të departamentit.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruarë të studimeve të ciklit të dytë;	IAL-ja kryen audit të përvitshëm për situatën financiare nga një kontabël i miratuar dhe i regjistruar. Raporti i audut përmban një pasqyrë të hollësishme referuar billancit për të ardhurat dhe shpenzimet e programeve të studimit.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituarë dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruarë të studimeve të ciklit të dytë;	Në 6 vjecarin e fundit, IAL-ja nuk ka përfituar nga asnjë grant i huaj apo kontrata shërbimesh. Programi i studimit financohet 100% nga tarifat e shkollimit
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në ciklet pasardhëse.
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport finanziar të kostove të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjetave dhe të pajisjeve, etj.	Zyra e Financës disponon raporte të cilat pasqyrojnë të dhëna të hollësishme financiare të të ardhurave dhe kostove të realizimit të programit (të ardhurat nga tarifat e shkollimit, kostot operacionale, kostot fikse, pagat, sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, kosto pajisjeve, tatimet mbi të ardhurat etj).
Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitet financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	Në lidhje me situatën financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen, për periudhën 6 vjecare konstatojmë që burimi kryesor i të ardhurave vjen nga tarifa e shkollimit të ardhura të cilat kanë një rrënie me 50%; gjithashtu departamenti nuk gjeneron të ardhura shtesë nga ofrimi i konsulencave apo shërbimeve ndaj të tretëve apo të përfitojë nga fonde dhe grante të ndryshme, të cilat ndihmojnë në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. IAL-ja disponon raporte financiare të të ardhurave dhe kostove, kryen audit të përvitshëm për situatën financiare 2. Programi i studimit financohet pothuajse 100% nga tarifat e shkollimit, të ardhura të cilat kanë pësuar 50% rrënie në 6 vitet e fundit 3. IAL-ja nuk gjeneron të ardhura shtesë nga ofrimi i konsulencave apo shërbimeve ndaj të 	



tretëve apo të përfitojë nga fonde dhe grante të ndryshme, të cilat janë burime alternative dhe mund të ndihmojnë në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë është institucionalizuar me vendim Senati Akademik Nr. 178 dt. 23/07/2010, dhe me vendimin Nr. 157/3 dt. 08/09/2016. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë funksionon edhe në nivel njësie bazë. Me vendimin nr. 4 dt. 22/12/2016 institucioni ka ngritur edhe Komisionin e Përherershëm për Vlerësim Institucional, i cili harton politikat e sigurimit të cilësisë në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe Standardet Shtetërore të Cilësisë. Funksionet dhe detyrat e NJSBC, janë të parashikuara në Rregulloren e Brendshme të Universitetit (neni 14) si dhe në Rregulloret specifike për sistemin e Sigurimit të Cilësisë. NJSBC ushtron funksion mbështetës, këshillimor, bashkërendues, monitorues dhe administrativ me strukturat e tjera akademike dhe administrative të IAL-së, si dhe ofron ekspertizë në zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është në varësi të drejtpërdrejtë të Rektorit, dhe ka për detyrë paraqitjen e raportit vjetor me informacione dhe vlerësime për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për permirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen. Raporti paraqitet dhe miratohet në Senatin Akademik, dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit. Në nivel departamenti me ngritjen e grupeve të Sigurimit të Cilësisë, rapporti analizon dhe vlerëson programet mësimore, literaturën dhe format e vlerësimit. Kontrolli dhe vlerësimi bëhen në bazë të të dhënavë statistikore, të mbledhura gjatë anketimeve të studenteve, fokus – grupeve, raportet e vetëvlerësimit të pedagogeve. raporteve semestrale dhe vjetore të njësive bazë, si dhe rezultateve të arritura nga studentet.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:**
- Sa anketime kanë bërë me studentët **2 anketime** në vit
 - Sa studentë janë anketuar **rreth 60% e studentëve**
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë

Janë përpunuar të gjitha të dhënat me metoda cilësore dhe sasiore. Problematikat e evidentuara në lidhje me stafin akademik dhe administrativ, literaturën kanë qënë të pakta, më tepër problematikat lidhen me infrastrukturën dhe tarifat e studimit

- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm



Pas evidentimit të problematikave kryen verifikimet dhe merren masa për ti adresuar dhe përmirësuar për vitet në vazhdim

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatit raport vjetor me informacione dhe vlerësimë për procesin e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, cilësinë e shërbimit akademik dhe administrativ të ofruar, si dhe rekomandon masa për permirësimin e parametrave të cilësisë në të ardhmen, i cili miratohet në Senatin Akademik.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Nj.S.B.C. për ruajtjen, nxitjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë bashkëpunon me njësitë bazë nëpërmjet Grupeve të Sigurimit të Cilësisë të ngritura në nivel departamenti, të cilat analizojnë dhe vlerësojnë programet mësimore, literaturën dhe format e vlerësimit

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Departamenti harton raport semestral dhe vjetor në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të viti akademik, në të cilin përfshihen të dhëna përshkruuese dhe sasiore mbi cështje që lidhen me programet e studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re, rezultatet e arritura të studenteve, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe ne fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat që duhet të merren për permirësimë në të ardhmen.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike


Raporti vjetor i departamentit paraqet në fund edhe analizën SWOT, duke evidentuar jo vetëm pikat e dobëta por edhe masat që duhet të merren për përmirësimë në të ardhmen.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none">Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të	<p>IAL-ja ngrë grupet e vlerësimit të brendshëm në nivel departamenti për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit sipas standardeve për kategoritë e përcaktuara në udhëzuesin e vlerësimit të brendshëm, me qëllim rishikimin e ndryshimeve në kurrikula dhe syllabuse si rezultat i studimit të tregut të punës, kërkesës së grupeve të interesit, i nevojës për përshtatje me legjislacionin në fuqi, kërkesës së pedagogeve apo studenteve.</p> <p>Ky relacion diskutohet paraprakisht në departament dhe më pas i përcillet në formë shkresore dekanit të Fakultetit i cili pasi ka marrë vlerësimin teknik nga Zyrat përkatëse të Zhvillimit të Kurrikulave e diskuton propozimin në mbledhjet e Dekanatit dhe vendimi i marrë miratohet zyrtarisht nga Senati Akademik në mbledhjen e radhës.</p> <p>Një praktikë e mirë konsiderohet raporti semestral</p>



<p>studimeve;</p> <ul style="list-style-type: none"> b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënieς, kurrikulës, të të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombejtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); b. Dëgjime në auditor; c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; h. Etj. 	<p>dhe ai vjetor që Departamenti harton në përfundim të semestrit të parë dhe në përfundim të vitit akademik, respektivisht në të cilin përfshihen të dhëna përshtkuuese dhe sasiore të hollësishme mbi çështje që lidhen me programet e studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, vlerësimin e pedagogëve, rezultatet e arritura të studenteve, mjediset dhe biblioteka, financimi i aktiviteteve të zhvilluara dhe kërkimi shkencor, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore dhe ne fund paraqitet analiza SWOT, si dhe masat që duhet të merren për përmirësime në të ardhmen.</p> <p>Ky raport përfundimtar publikohet në faqen zyrtare të IAL-së në përfundim të cdo viti akademik (p.sh shih https://albanianuniversity.edu.al/wp-content/uploads/2017/04/Raporti-Vjetor-NJSBC-2016-2017-Perfundimtar.pdf)</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit, IAL-ja përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta. Në përfundim të çdo semestri pedagogët plotësojnë raportin e vetëvlerësimit, i cili lidhet me ecurinë e programit mësimor, përqindjen e realizimit të objektivave mësimore, përqindjen e kalueshmërisë së studentëve për lëndën specifike, si dhe propozime për përmirësime të mundshme në të ardhmen. Gjithashtu, edhe Përgjegjësi i departamentit ploteson për çdo pedagog një raport vlerësimi për çështja të tillë, si korrekëtsia administrative, veprimtaria kërkimore - shkencore etj.</p> <p>Vlerësimi i pedagogëve bëhet edhe përmes pyetësorëve online me studentët (2 herë në vit) në fund të semestrit, përpara fillimit të sezonit të provimeve, duke ruajtur anonimatin e studentëve, si dhe fokus – grupeve me studentë (në muajin dhjetor).</p>
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, butejtje etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Raporti vjetor i departamentit diskutohet në departament dhe në rank fakulteti dhe pasi miratohet nga Senati Akademik ai publikohet në faqen e internetit të IAL-së në përfundim të vitit akademik.</p> <p>Gjithashtu IAL-ja publikon online raportin vjetor të vlerësimit të brendshëm të cilësisë realizuar nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (shih https://albanianuniversity.edu.al/sq/sigurimi-i-brendshem-i-cilesise/)</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	



<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruese të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruese të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Departamenti përgatit, diskuton dhe shpërndan në formë shkresore një raport të detajuar të vlerësimit periodik mbi ecurinë dhe cilësinë e punës së departamentit, i cili u vihet në dispozicion pedagogëve, strukturave drejtuese por edhe të tjerë të interesuar.</p> <p>Raporti vjetor i departamentit bën edhe një analizë SWOT, të pikave të dobëta si dhe propozon masa konkrete për adresimin e tyre. Këto raporte janë pjesë e komunikimit dhe diskutimit në nivel departamenti, fakulteti dhe Senati Akademik.</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standarde institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpëra aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategja, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>IAL-ja paraprakisht ka plotësuar standarde institucionale dhe është akredituar në nivel institucional me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 90, datë 20.10.2017 për periudhën 20/10/2017 deri në 19/10/2019.</p> <p>Për sigurimin e cilësisë, IAL-ja ka ngritur strukturat përkatëse deri në nivel njësie bazë të cilat vlerësojnë dhe monitorojnë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, në përputhje me procedurat dhe standarde për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e lartë.</p> <p>Funksionet dhe detyrat e NJSBC, si dhe mënyra e organizimit të vlerësimit të brendshëm, aktivitetet që kryhen, përgjegjësitë dhe mënyra e paraqitjes së rezultateve përcaktohen në rregulloren e brendshme të Universitetit si dhe në Rregulloret specifike për sistemin e Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Vlerësimi i brendshëm i programeve të studimit apo institucional organizohet nga NJSBC si rregull një herë në 3 vjet dhe nëse është e nevojshme, NJSBC mund të organizojë vlerësimë të pjesshme edhe më shpesh.</p> <p>Ndërgjegjësimi i personelit akademik mbi rëndësinë dhe sigurimin e cilësisë arrihet nëpërmjet diskutimit të rapportit vjetor të vlerësimit në departament si dhe shpërndarjes së tij në formë shkresore dhe publikimit në faqen e internetit, duke siguruar informimin e pedagogëve, strukturave drejtuese, si edhe studentëve.</p> <p>Raporti vjetor i departamentit paraqet në fund edhe analizën SWOT, duke evidentuar jo vetëm pikat e dobëta por edhe masat që duhet të merren për përmirësimin e cilësisë. Të gjithë këta elementë janë pjesë e strategjisë së përgjithshme të zhvillimit të IAL-së.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. IAL-ja paraprakisht ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional me Vendim Bordit të Akreditimit Nr. 90, datë 20.10.2017 për periudhën 20/10/2017 deri në 19/10/2019.
2. IAL-ja përvèc Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ngrë grupet e vlerësimit të brendshëm në nivel departamenti për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimit sipas standardeve për kategoritë e përcaktuara në udhëzuesin e vlerësimit të brendshëm,
3. Për kryerjen e vlerësimit, IAL-ja përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta, si reportin e vetëvlerësimit nga çdo pedagog, rapporti i vlerësimit të Përgjegjësit të departamentit, vlerësimet e studentëve përmes pyetësorëve online dhe fokus – grupeve.
4. Një praktikë e mirë konsiderohet rapporti vjetor i Departamenti i cili përfshin të dhëna pëershkruese dhe sasiore të hollësishme mbi çështje që lidhen me programet e studimit, vlefshmérinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, vlerësimin e pedagogëve, rezultatet e arritura të studenteve, mjediset dhe biblioteka, financimi i aktiviteteve të zhvilluara dhe kërkimi shkencor, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore si dhe analiza SWOT, ku përvèc evidentimit të pikave të dobëta propojohen edhe dhe masat që duhet të merren për përmirësimë në të ardhmen
5. Këto raporte janë pjesë e komunikimit dhe diskutimit në nivel departamenti, fakulteti dhe Senati Akademik.
6. Raporti i departamentit si dhe rapporti i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë publikohet në faqen zyrtare të IAL-së në përfundim të cdo viti akademik


POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përbajtja e programit, organizimi i vitiit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi studimi të ciklit të dytë Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" synon pajisjen e të diplomuarve me njohuri bazë mbi teoritë e shkencave administrative, procedurat, politikat, institucionet lokale dhe qeverisjen e tyre, duke i kushtuar një vëmendje të vecantë dimensionit dhe njohjes së strukturave, institucioneve, dhe legjislacionit kombëtar. Njohja e studentëve me koncepte bashkëkohore si financat publike, komunikimi, qeverisja vendore, teoria dhe praktikat si dhe funksionimi i administratës publike janë pjesë e objektivave formuese të këtij programi studimi. Ky program studimi zhvillon aftësinë për të drejtuar studime dhe kërkime në mënyrë të pavarur, pajis studentin me metodologji të avancuar në fushën e studimeve mbi administratën publike, i profilizon ata në drejtime të veçanta studimesh të krahasuara, i ofron përqasje ndërdisiplinore në fushat e administrimit publik, u ofron njohuri mbi metodat sasiore të zhvilluara mbi përmirësimin e administratës publike, i njeh me modelet dhe vizionet bashkëkohore mbi pozicionimin



e administratës publike në kontekstin e globalizimit dhe integrimit evropian, si dhe analiza sistemike në çështje kombëtare. Të diplomuarit pajisen me aftësi për konstruksione logjike me bazë teorike dhe empirike, kompetenca argumentuese dhe këshilluese për institucionet qeveritare që mbulojnë marrëdhëniet e administratës me publikun.

Programi i Studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" zhvillohet me kohë të plotë dhe me frekuentim të detyrueshém në masën 75%, dhe me Vendim Senati Nr.6, datë 2018-02-28 dhe pas miratimit nga MARS me Shkresë Nr., datë 2018-07-18, ky program studimi ofrohet nga 2018-2019 e në vazdim me kohëzgjatje normale 1 vit të cilës i përkon 60 kredite.

Veprimitaria mësimore parashikon një spektër të gjërë disiplinash formuese bazë, karakterizuese dhe të ngjashme ose integrues, të cilat zhvillohen nëpërmjet leksioneve tradicionale në auditor, seminareve, ushtrimeve me shkrim ose me gojë, moduleve mësimore plotësues. Programi mësimor është i ndërtuar nga 1500 orë studimi në total, nga të cilat 585 janë orë studimi në auditor dhe 915 janë orë studimi individual. Viti akademik zgjat 30 javë mësimore dhe Studenti zhvillon deri në 25 orë mësimore në auditor cdo javë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publike" është licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 597, datë 28/05/2009 si Master i Nivelit të Parë, MNP, dhe është riorganizuar nga MNP në MP me Vendim Senati Nr. Prot. 192, datë 25.01.2011. Programi është akredituar pozitivisht me Urdhër Nr. 499, datë 18.10.2012 dhe Vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 363, datë 17.09.2012. Ky program studim është riorganizuar në 60 ECTS me kohëzgjatje 1 vit akademik me vendim senati nr. 6 datë 28.02.2018 dhe miratuar me shkresë MASR Nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Plani mësimor (90 ECTS 2012-2017) i këtij programi është ndarë në tre semestra respektivisht 25 ECTS, 27 ECTS, 38 ECTS. Ngarkesa mësimore e çdo lënde është shprehur në numër orësh mësimore dhe vlerën respektive në ECTS. Orët mësimore janë të organizuara në leksione dhe seminare, të ndara në orë në auditor dhe punë të pavarur, Ky plan mësimor është riorganizuar në 2018-2019 në 60 ECTS i ndarë në dy semestra me 30 ECTS respektivisht. Gjithashtu, ka një shpërndarje orësh të seminareve në orë ushtrimesh dhe detyra dhe projekte të realizuara në auditor dhe punë e pavarur.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet 300 orë në auditor dhe 325 orë punë e pavarur e studentit

▪ Për Seminaret	137	orë në auditor dhe	313	orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Laboratoret	0	orë në auditor dhe	0	orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikat lëndore	0	orë në auditor dhe	0	orë punë e pavarur e studentit
▪ Për Praktikën Profesionale	120	orë në auditor dhe	30	orë punë e pavarur e studentit
▪ Provimi përfundimtar	12	orë në auditor dhe	138	orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Lënda "Financë Publike" nga lëndë karakterizuese (B) kalon në lëndë ndërdisiplinore/integruese - lëndë me zgjedhje, numri i krediteve nuk ka ndryshuar (mbetet sërisht me 4 kredite ECTS), dhe për herë të parë në grup lendët me zgjedhje është futur si lëndë e re "Analiza e politikave publike" Lënda e cila zëvendëson lëndën "E drejtë Finanziare" me 5 kredite ECTS. Ky ndryshim ka marrë në konsideratë nevojën e studentëve të këtij programi mësimor. Studenti ka detyrim të zgjedhë një prej dy lëndëve të ofruara. Lendët "E drejtë e mjedisit" kalon në lëndë me zgjedhje dhe "E drejta e punës dhe sigurisë Sociale" nga lëndë karakterizuese (B) kalon si lëndë me zgjedhje (C). Numri i krediteve ndryshon vetëm për lëndën "E drejtë e punës dhe Sigurisë sociale" e cila nga 5 kredite ECTS, bëhet 4 kredite ECTS. Lënda "Teknologji e Informacionit" hiqet nga kurrikula për arsyet e kushtëzimit të numrit të krediteve dhe përqindjen që duhet të zënë lëndët e kategorisë (D), sipas Udhëzimit Nr 41 ku përfshihen (Gjuhë e Huaj, Njohuri informatike, Praktikë profesionale.)

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Numri më i madh i lëndëve janë mbuluar nga pedagogë me kohë të pjesshme, kjo është reflektuar edhe në ndryshimet e vazdueshme të pedagogëve të cilët jepin lëndët e lidhura me programin mësimor duke krijuar një mos-vazhdimësi pedagog-lendë e ofruar. Një pedagog nuk ka më shumë se dy lëndë në këtë program studimi. (**Sipas Tab Nr. 8 RVB**)

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Syllabuset i kanë të gjitha elementët (informacion i përgjithshëm, rezultatet e të nxënët, kompetencat, konceptet themelore, temat e lëndës, metodologjinë e mësimdhënies, format e kontrollit dhe literaturën e detyruar dhe të rekonduar). Ato janë të standartizuara për të gjitha modulet si më poshtë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS



- Format dhe metodat e mësimdhëties të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Syllabuset e lëndëve janë të fokusuar në kompetencat që studentet do të përfitojnë. Ato evidentojnë konceptet themelore dhe temat që do të trajtohen në leksione dhe seminare duke i përshkruar në mënyrë të përmbledhur dhe duke sugjeroar literaturën e nevojshme për referencë. Ato përbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi lëndën.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij. <p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Vlerësimi sipas standardeve</p> <p>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</p> <p>Programi i studimit është i licencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 597, datë 28/05/2009 si Master i Nivelit të Parë, MNP, dhe është riorganizuar nga MNP në MP me Vendim Senati Nr. Prot. 192, datë 25.01.2011. Programi është akredituar pozitivisht me Urdhër Nr. 499, datë 18.10.2012 dhe Vendim të Këshillit të Akreditimit Nr. 363, datë 17.09.2012.</p> <p>Ky program studim është ofruar me 90 ECTS dhe vetëm në vitin akademik 2018-2019 është riorganizuar në 60 ECTS me kohëzgjatje 1 vit akademik, me Vendim Senati Nr. 6 datë 28.02.2018 dhe miratuar me shkresë MASR Nr. 6313/2 prot, datë 18.07.2018.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukur" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njoħuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukur" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njoħuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integrarura të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njoħuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas</p>	<p>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" pajis té diplomuarit me aftesi teorike mbi qeverisjen dhe administrimin si dhe stimulon aftesitë praktike për analiza sistemike kombëtare dhe rajonale, nён raportin e standardeve dhe rregullave të testimit empirik të profilit. Ky program studimi zhvillon aftesinë për të drejtuar studime dhe kërkime në mënyrë të pavarur, pajis studentët me metodologji të avancuar në fushën e studimeve mbi administratën publike, i profilizon ata në drejtime të vecanta studimesh të krahasuara, i ofron përqasje ndërdisiplinore në fushat e administrimit publik, u ofron njoħuri mbi metodat sasiore të zhvilluara mbi pëmirrésimin e administratës publike, i njeh me modelet dhe vizionet bashkëkohore mbi pozicionimin e administratës</p>



<p>fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij ciklli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukurë" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njojurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njouri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>publike në kontekstin e globalizimit dhe integrimit evropian.</p> <p>Ky program studimi shhang përsëritjen e njojurive formuese të programeve të studimit të ciklit të parë, pasi ofron disiplina të karakterit profilizues profesional, të cilat karakterizohen nga specialiteti sektorial, si dhe nga niveli më i lartë i kompleksitetit teknik me qëllim formimin teorik në nivelin e fushës përkatëse të studimit.</p> <p>Programi i studimit i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij.</p> <p>Si dhe krijon baza të qëndrueshme njojurish për studimet të mëtejshme duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve për pranimin në ciklin e tretë të doktoratës.</p> <p>Programi i studimit ka objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njojurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Përbajtja dhe renditja e objektivave të programit të studimit, është objektiv dhe arritja e qëllimeve është në përputhje me nivelin e ciklit të dytë të studimeve.</p> <p>Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme, duke u dhënë mundësi atyre të plotësojnë njojuritë dhe të sqarojnë paqartësitë gjatë semestrit. Përvec vlerësimit përfundimtar (që përbën 60% të notës), studenti vlerësohet përmes provimeve të ndërmjetme (20%) dhe pjesëmarrjes aktive gjatë seminareve (10%), ushtimeve dhe detyrave të kursit (10%), duke mundësuar ndjekjen e ecurisë së të nxenit gjatë gjithë semestrit.</p>
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkuruese për nga elementet që përbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njojurive të fituaara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin</p>	<p>Programi i studimit mbështetet në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të IAL-së duke i mëshuar përqasjes ndërdisiplinore në fushat e administrimit publik.</p> <p>Për nga elementët formalë të këtij programi studimi (numri i krediteve, kushteve të pranimit/transferimit, metoda e vlerësimit) kz program studimi mund të konsiderohet konkuruese, megjithatë nëse konsiderojmë ekspertizën dhe fokusin në trajtimin e çështje lokale atëherë ky program studimi bëhet më pak konkurruar në tregun rajonal.</p>



dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.	Programi i studimit është hartuar kryesisht për tregun rajonal, megjithatë ai synon të jetë sa më afër standardeve evropiane.
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;	Programi i studimit vec lëndëve teorike, përfshin në një pjesë të madhe të programit mësimor (20%) aftësimin profesional (praktikës profesionale 6 ECTS) dhe kërkimin shkencor duke e angazhuar studentin në përgatitjen e mikro-tezës (6 ECTS).
Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;	Gjithsesi, vlerësojmë që raporti midis aftësimit profesional-kërkimit shkencor të ishte në raport që të avantazhonte praktikën nisur nga profili profesional i programit të studimit.
Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizmin e programeve të studimeve;	Programi është hartuar në perputhje me strategjinë e zhvillimit institucional dhe atë të Departamentit të Shkencave Politiko-Administrative.
Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	Kryesisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë personeli akademik është i angazhuar në kuadër të kërkimit shkencor duke përfshirë studentët përmes mikro-tezës.
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	Nisur nga fakti që administrata publike në mënyrë të vazhdueshme shpall vende të lira punë si dhe nevojës për ekspertë të kualifikuar në fushën e administrimit publik, gjykojmë që programi i studimit i përshtatet nevojave të tregut të punës.
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	Duke pasur nevojë për specialistë të lartë në fushën e administrimit dhe profilit publik të institacioneve, shumë prej këtyre vendeve të punës kërkojnë profil të shkencave shoqërore me specializim në administrim dhe qeverisje. Ky program studimi synon të plotësojë këto nevoja.
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Programi i studimit përvec se merr parasysh nevojat e tregut të punës ai është hartuar në përputhje edhe me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar, duke pasur parasysh edhe përpjekjet e Shqipërisë për integrimin evropian dhe përbushjen e kushteve të një administratë të specializuar.
Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; b. kërkesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të registrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.	Për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, IAL-ja ka kryer një studim tregu për këtë program studimi duke shqyrtau dokumentet dhe studimet aktuale, si dhe nga të dhënat Alumni mbi punësimin e të diplomuarve ndër vite.



Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interest kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Konstatojmë se programi i studimit nuk bien ndesh me interesat kombëtare, për më tepër ai synon formëzimin e profesionistëve në fushën e hartimit të politikave dhe administrimit kombëtar në nivel lokal dhe qëndror, duke trajtuar dhe u fokusuar në tematika kombëtare.</p> <p>Për më tepër programi i studimit mbron interesat kombëtarë duke përgatitur ekspertë të cilët do të ndihmojnë zhvillimin dhe mirëqënen e shoqërisë Shqiptare</p>
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Programi i Studimit Master Profesional në Qeverisje dhe Administrim Publik" për studentet e regjistruar në vitet akademike 2012-2017 është realizuar me 90 ECTS dhe kohëzgjatje 1.5 vite.</p> <p>Duke filluar nga viti akademik 2018-2019, ky program realizohet me 60 ECTS sipas riorganizimit në përputhje me ligjin.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e integruarë të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës "Master i Shkencave". Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruarë të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	N/A
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësish i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>IAL-ja ndjek praktikën e zhvillimit të javës orientuese për studentët cdo fillim viti akademik ku studentët njihen më nga afër edhe me programet mësimore, të drejtat dhe detyrat e tyre.</p> <p>Gjithashtu, informacionet për programin e studimit, të drejtat dhe detyrimet e studentëve apo informacione të tjera janë në dispozicion të studentëve si në format të printuar broshure, fletpalosje apo postera, ashtu edhe në format elektronik në faqen zyrtare të IAL-së (shih https://albanianuniversity.edu.al/sq/broshura-per-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve/)</p> <p>Informacioni për syllabuset e lëndeve u bëhet me dije studentëve në fillim të secilit modul nga pedagoget përgjegjës të lëndëve, njësise bazë dhe nëpërmjet broshurave informuese (shih https://albanianuniversity.edu.al/sq/sq/manuali-i-studenteve/)</p>

Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruarë të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

N/A

Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

Konkluzionet e vlerësimit:


1. Programi i studimit është i akredituar si dhe i organizuar në module të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, me 60 ECTS, 1 vit akademik pas riorganizimit në përputhje me ligjin në 2018.
2. Programi i studimit mbështetet në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të IAL-së duke i mëshuar përqasjes ndërdisiplinore në fushat e administrimit publik.
3. Programi i studimit përvec se merr parasysh nevojat e tregut të punës (analizë e dokumenteve dhe studimeve aktuale, si dhe nga të dhënat Alumni mbi punësimin e të diplomuarve ndër vite), është në përputhje me zhvillimet kombëtar, dhe nuk bie ndesh me vlerat kombëtare
4. Informacionet për programin e studimit, të drejtat dhe detyrimet e studentëve apo informacione të tjera janë në dispozicion të studentëve si në format të printuar ashtu edhe elektronikisht
5. Programi i studimit i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale me baza të qëndrueshme njojurish për studimet të mëtejshme duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve për pranimin në ciklin e tretë të doktoratës.
6. Programi i studimit vec lëndëve teorike, përfshin në një pjesë të madhe të programit mësimor (20%) aftësimin profesional (praktikës profesionale 6 ECTS) dhe kërkimin shkencor - mikrotezën (6 ECTS). Gjithsesi, vlerësojmë që raporti midis aftësimit profesional dhe kërkimit shkencor, të programonte më shumë praktikë sesa mikrotezën nisur nga profili profesional i programit të studimit.
7. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme, duke u dhënë mundësi atyre të plotësojnë njojuritë dhe të sqarojnë paqartësitë gjatë semestrit.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma referencë: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njojurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjite e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Organizimi i mësimdhënies bëhet në bazë grupei dhe lënde. Format e mësimdhënies përfshijnë Leksione dhe seminar në auditor, si dhe ushtrime dhe detyra kursi. Metodat e mësimdhënies janë një ndërthurje e shpjegimit klasik dhe prezantimit me ndihmën e video-projektorit të materialeve didaktike të përgatitura nga pedagogu i lëndës. Numri total i veprimitarive formuese është 12, ku janë parashikuar 10 lëndë, për secilën prej tyre parashikohet provim final, si dhe praktika dhe teza e diplomës. Frekuentimi, si rregull është i detyrueshëm në seancat në auditor. Për studentet që kanë munguar me arsyë në jo më shumë se 25% të seansave të rregullta të disciplinave të kontrollit planifikohen deri në dy seansa plotësuese për cdo semester dhe lëndë. Studenti nuk pranohet në



sesionin e parë të provimit nëse ka me shume se 25% të mungesave në seansat mësimore në auditor. Nëse ka mbi 50% mungesa ai duhet të përsëritë atë lëndë.

Kontrolli i njojurive të studentëve percaktohet në Rregulloren mësimore të programit të studimit dhe në syllabusin e cdo lënde.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet

• Leksione	300 orë
• Seminare	137 orë
• Ushtrime	7 orë
• Laboratore	0
• Detyre	21 orë
• Praktikë lëndore	0
• Praktikë profesionale	120 orë
• Temë diplome	12 orë

Format e kontrollit të njojurive

Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme, duke u dhënë mundësi atyre të plotësojnë njojuritë dhe të sqarojnë paqartësitë gjatë semestrit. Përvec vlerësimit përfundimtar (që përbën 60% të notës), studenti vlerësohet përmes provimeve të ndërmjetme (20%) dhe pjesëmarrjes aktive gjatë seminareve (10%), ushtimeve dhe detyrave të kursit (10%), duke mundësuar ndjekjen e ecurisë së të nxenit gjatë gjithë semestrit.

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

3 studentë janë angazhuar në punime shkencore individuale të pedagogëve, dhe 6 studentë janë angazhuar në projekte në rang departamenti ose fakulteti, dhe një student në projekte shkencore me të tjerë.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Për pranimin në programin e studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" studenti duhet të ketë përfstuar diplomë të ciklit të parë të studimeve Bachelor në fushën e shkencave politike, ekonomike, juridike dhe sociale; të plotësojë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë, si dhe të paguajë tarifën e caktuar vjetore.



Dokumentat e aplikimit që përbëjnë dosjen e pranimit janë:

- Formulari i aplikimit;
- Letër interesit për programin e studimit;
- Kopje e noterizuar e Diplomës së Nivelit të Parë ose një diplome tjeter studimi të fituar jashtë vendit ekuivalente;
- Lista e notave e noterizuar;
- CV-ja e kandidatit ku paraqiten të dhëna biografike;
- Dokument identifikimi dhe 2 fotografi.

Afati maksimal i përfundimit të studimeve të plota është 2 vite akademike (dyfishi i afatit të rregullt), pa marrë në konsideratë periudhën e kohës kur studenti i ka pezulluar studimet. Në vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 janë regjistruar për secilin vit 28 studentë, numër ky i cili ka ardhur në rënie nëse konsiderojmë vitet parardhëse (p.sh. në vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar 71 studentë).

Nota mesatare hyrëse për vitin akademik 2017-2018 ka qënë 6.71, dhe ka ardhur në rënie nëse konsiderojmë vitet paraardhëse (në vitin akademik 2012-2013 nota mesatare hyrëse ka qënë 7.26).

Të gjithë studentët të cilët përfundojnë studimet e tyre në programin Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” janë studentë Alumni. Zyra e Karrierës dhe Alumnit kujdeset në mënyrë periodike për krijimin e një database statistikash të punësimit të studenteve pas përfundimit të studimeve. Në total, përgjatë periudhës 2012-2018 janë diplomuar 229 studentë, prej të cilëve 95 janë punësuar në përputhje me diplomën dhe 49 janë të punësuar jo në përputhje me diplomën.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Kriteret akademike vendosen nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë, dhe për programin e studimit Master Profesional në “Qeverisje dhe Administrim Publik” kandidati duhet që të: ketë diplomë të ciklit të parë të studimeve Bachelor ose ekuivalente (180 kredite ECTS); të plotësojë dosjen me dokumentet e kërkuar nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë; dhe të paguajë tarifën e caktuar vjetore. Nuk ka kritere specifike për pranimin e studenteve në këtë program studimi.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia në hyrje e studentëve për këtë program studimi është në rënie nëse konsiderojmë notën mesatare hyrëse. Për vitin akademik 2012-2013 nota mesatare hyrëse ka qënë 7.26 ndërsa për vitin akademik 2017-2018 nota mesatare hyrëse ka qënë 6.71 dhe ajo dalëse 7 (kalueshmëria 67.8%). Cilësia e studentëve në dalje ka një rritje jo të ndjeshme.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare



Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi ka ardhur në rënien, aktualisht 40% studentë më pak se vitet e mëparshme.

Numri i studentëve ndër vite;

Për vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar **71** studentë nota mesatare hyrëse **7.26**

Për vitin akademik 2013-2014 janë regjistruar **14** studentë nota mesatare hyrëse **7.3**

Për vitin akademik 2014-2015 janë regjistruar **36** studentë nota mesatare hyrëse **7.36**

Për vitin akademik 2015-2016 janë regjistruar **51** studentë nota mesatare hyrëse **7.02**

Për vitin akademik 2016-2017 janë regjistruar **31** studentë nota mesatare hyrëse **6.48**

Për vitin akademik 2017-2018 janë regjistruar **28** studentë nota mesatare hyrëse **6.71**

Për vitin akademik 2018-2019 janë regjistruar **28** studentë

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)

Në total, përgjatë periudhës 2012-2018 janë diplomuar **229** studentë

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Vetëm vitet e fundit, pasi 2016, ka patur studentë të rregjistruar me transferim në vit të parë, numër i vogël në krahasim me numrin total të studentëve.

2012-2013 janë regjistruar 71 studentë për herë të parë në vit të parë.

2013-2014 janë regjistruar 14 studentë për herë të parë në vit të parë

2014-2015 janë regjistruar 36 studentë për herë të parë në vit të parë

2015-2016 janë regjistruar 51 për herë të parë në vit të parë

2016-2017 janë regjistruar 31 studentë, 29 studentë për herë të parë në vit të parë dhe **2** studentë të rregjistruar me transferim në vit të parë

2017-2018 janë regjistruar **28** studentë, 27 studentë janë rregjistruar për herë të parë në vit të parë dhe 1 student është rregjistruar me transferim në vit të dytë.

2018-2019 janë regjistruar **28** studentë

Të dhëna për punësimin e studentëve

Në total, përgjatë periudhës 2012-2018 janë diplomuar 229 studentë dhe punësuar 144 prej tyre (**rreth 63%**), prej të cilëve 95 (42%) janë punësuar në përputhje me diplomën dhe 49 janë të punësuar jo në përputhje me diplomën.

Numri total të diplomuarve

229 studentë të diplomuar

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

95 studentë

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)



Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zoterojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Studentët të cilët ndjekin programin e studimit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim" zoterojnë së paku diplomë të ciklit të parë me 180 kredite ECTS
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Studentët e regjistruar në këtë program studimi plotësojnë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë, diplomë të ciklit të parë, dosjen e studentit dhe pagesën vjetore të tarifës së studimit. Nuk ka kritere specifike për pranimin e studenteve në këtë program studimi.
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Dokumentat e aplikimit që përbëjnë dosjen e pranimit janë formulari i aplikimit, letër interesit për programin e studimit, kopjen e noterizuar e Diplomës së Nivelit të Parë ose një diplome tjeter studimi të fituar jashtë vendit ekuivalente, lista e notave e noterizuar, CV-ja e kandidatit ku paraqiten të dhëna biografike, dokument identifikimi dhe 2 fotografie.
Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japid deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;	Në përputhje me kuadrin ligor në fuqi, studentët e regjistruar në programet e studimit Master Profesional, nuk kanë detyrim ligor njohjen e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian dhe institacioni nuk e ka kusht pranimi njohjen e një gjuhe të huaj.
Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.	Njësia bazë ka komisionin e pranimeve i cili mund të përditësojë sipas rastit politikat dhe kriteret e pranimit në funksion të përparimit të mëtejshëm të studentëve, por aktualisht përparimi i studentëve si përsa i përket numrit dhe cilësisë (nota mesatare në hyrje) janë në rënje.
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitet për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;	Zyra e Karrierës dhe Alumnit siguron lidhjet për studentet, komunitetin e gjërë universitar dhe tregun e punës. Ajo zhvillon aktivitete si panairi i karrierës në qershori me të gjithë studentët si dhe open days duke ftuar studentë ku diskutohet dhe ndahen eksperiencat personale mbi punësimin. Studentëve u vihet ne dispozicion informacion për mundësitet për punësim nëpërmjet takimeve
Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;	



<p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>dhe broshurave informuese.</p> <p>Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studenteve organizon në javën e parë mesimore të fillimit të viti akademik takime të hapura ku studentet njihen edhe me licensimin dhe akreditimin e programeve të studimit si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion.</p> <p>Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës nëpërmjet takimeve të vazhdueshme ku diskutohen cështje të karrierës, si p.sh. si të prezantohemi denjësisht në një intervistë pune, si të shkruajnë një CV, etj; si edhe nëpërmjet broshurave të përgatitura si psh “Udhëzuesin për Zhvillimin e Karrierës”</p>
<p>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruarat e studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruarat e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Institucioni mban të dhëna statistikore mbi numrin e të regjistruarve, të transferuarve dhe të larguarve nga programi i studimit; të dhëna për numrin e të diplomuarve që kanë përfunduar programin e studimit; si dhe të dhëna mbi ecurinë e studimeve të tyre, që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruarat e studimeve të ciklit të dytë.</p> <p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruarat e studimeve të ciklit të dytë si dhe përvendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Institucioni përmes Zyrës së Karrierës dhe Alumnit, harton një bazë të dhënash mbi punësimin e të diplomuarve dhe ndjekjen e studimeve të mëtejshme, informacion i cili përditësohet dhe mbahet deri në 5 vjet. Ky informacion sigurohet përmes kontakteve telefonike dhe me email.</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p> <p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e</p>	<p>Gjatë javës orientuese në fillim të vitit Akademik, studentët e rinj informohen në hollësi nga departamenti dhe Zyra e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studenteve për programet e studimit, organizimin dhe kohën e përfundimit, si</p>



<p>vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>dhe statusin e akreditimit.</p> <p>Studentet informohen për rezultatet e vlerësimit në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogët e lëndës për vlerësimin e aktivizimit, detyrave të kursit, provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar, si edhe sekretaria mësimore mbi vlerësimet përgjatë semestrit.</p> <p>Studenti ka të drejtë të njihet me tezën e provimit, pikët totale dhe për cdo rubrikë të vlerësimit, pas korrigjimit nga pedagogu. Nëse studenti konstaton se ka rubrika të pakorrigjuara apo pikë të pa llogaritura në vlerësimin total, ai ka të drejtë të depozitojë për shqyrtim në sekretarinë mësimore të degës përkatëse një kërkesë me shkrim, brenda 48 orëve nga shpallja e rezultateve.</p>
---	---

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p>	<p>Departamenti ofron udhëheqje dhe kujdestari (tutorial) për studentet që hasin vështirësi për përvetësimin e lëndës apo plotësimin e detyrimeve të ndryshme të programit të studimit, nëpërmjet orëve të konsultimit të zhvilluara me pedagogët.</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Departamenti me mbështetjen e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit orienton studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilën do të zhvillojnë praktikën profesionale. Praktikat profesionale zhvillohen në institucionet me të cilat IAL-ja ka marrëveshje bashkëpunimi.</p>

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Studentët e regjistruar në Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik" plotësojnë kriteret akademike të vendosura nga komisioni i pranimeve të njësisë bazë, diplomë të ciklit të parë (180 kredite ECTS), dosjen e studentit dhe pagesën vjetore të tarifës së studimit. Nuk ka kriterë specifike për pranimin e studenteve në këtë program studimi dhe detyrim i njohjes së një gjuhe të huaj
2. Departamenti në bashkëpunim me Zyrën e Koordinimit dhe Mbështetjes ndaj Studenteve informon rreth programit të studimit nëpërmjet takimeve në javën informuese dhe broshurave informuese.
3. Institucioni mban të dhëna statistikore mbi numrin e të regjistruarve, të transferuarve, të larguarve dhe atyre që kanë përfunduar programin e studimit
4. Studentet informohen për rezultatet e vlerësimit në mënyrë të vazhdueshme nga pedagogët e lëndës si edhe sekretaria mësimore.
5. Departamenti ofron udhëheqje dhe kujdestari për studentet që hasin vështirësi.
6. Departamenti me mbështetjen e Zyrës së Karrierës dhe Alumnit orienton studentët për zhvillimin e praktikës profesionale në institucionet me të cilat IAL-ja ka marrëveshje bashkëpunimi.
7. Zyra e Karrierës dhe Alumnit siguron lidhjet për studentet dhe tregun e punës, nëpërmjet aktiviteteve me të ftuar studentë Alumni apo panairit të karrierës, trajnimeve të ndryshme në



lidhje me prezantimin në një interviste pune, shkrimin e një CV. Kjo zyrë mban të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektit e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Veprimtaria kërkimore - shkencore e IAL-së organizohet dhe zhvillohet në përputhje me ligjin, Statutin dhe Strategjinë e Institucionit. Pedagoget kanë kryer punime studimore të cilat i kanë prezantuar në konferencat e organizuara nga vetë institucioni ose të organizuara nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Udhëheqjet e punimeve të studenteve të programeve Master janë pjesë e punës kërkimore të stafit pedagogjik. IAL-ja gjithashtu publikon revistën periodike “OPTIME”.

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative ka marrëveshje bashkëpunime me disa institucione publike, private, dhe OJF me të cilat bashkëpunon për të transmetuar rezultatet e punës kërkimore por edhe në funksion të mësimdhënieve. Ne kuadër të veprimtarisë kërkimore janë mbajtur leksione të hapura apo worshopë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

Aktivitetet e kërkimit shkencor janë në nivel individual, dhe përfshijnë botime të personelit akademik (72 botime), angazhim në projekte (7 projekte të fituara dhe 4 të realizuara individualisht nga stafi akademik), pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL-së (45) dhe përfshirja e studentëve në punime shkencore (6 student)

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Personeli akademik prezanton punimet shkencore në konferenca të organizuara nga IAL-ja dhe ato ndërkombëtare, si dhe i publikon rezulatat e kërkimit në revista shkencore.
Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	Angazhimi i stafit akademik në këto veprimtari shkencore është përgjithesish ndihmesë në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të shërbimit.



Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.

Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zoteron një certificate për njohje të avancuar të saj;

Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative, ofron mësimdhënie në gjuhën shqipe, megjithatë një pjesë e stafit kanë përfunduar studimet në Universitetet jashtë vendit dhe kanë aftësi për të mbuluar mësimdhëni në gjuhë te huaj.

Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;

Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimorshkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.

IAL-ja ofron Doktoraturë në Shkenca Administrative, edhe si një mundësi për kualifikimin e mëtejshëm të personelit akademik pa grada.

IAL-ja ofron disa trajnime dhe workshopë të brendshme, megjithatë mbetet sfidë angazhimi dhe organizimi i kurseve dhe trajnimeve të mëtejshme të mbështetura nga IAL-ja.

Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.

Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Institucioni disponon të dhëna mbi studimet shkencore të personelit akademik si botimet, kumtesat dhe angazhimin në projekte të personelit akademik të programit të studimit. Kjo bazë të dhënash rifreskohet cdo vit.

Në veprimtarinë shkencore të departamentit përfshihen konferencat shkencore (si p.sh. konferanca ndërkontakta mbi Problemet dhe sfidat e transformimit të shoqërisë shqiptare, konferanca studentore me temë sistemin e drejtësisë në Shqipëri); leksione të hapura në bashkëpunim me bibliotekën kombëtare, drejtorin e përgjithshme të arkivave, ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve; projekte të përbashkëta me universitetet partnerë (p.sh me Universitetin e Korçës, UNDP etj.) si dhe publikime në revista shkencore.

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Personeli akademik i përfshirë në këtë program studimi angazhohet rregullisht në veprimtar kërkimore shkencore, me karakter teoriko-aplikativ.
2. Punimet shkencore, prezantimet në konferanca, botimet dhe angazhimi në projekte janë rezultat individual i personelit akademik. Megjithatë institucioni mban një bazë të dhënash
3. IAL-ja në nivel institucional, duhet të bëjë përpjekje për të mundësuar kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik dhe atij mësimor shkencor nëpërmjet angazhimit dhe organizimit të kurseve dhe trajnimeve të mëtejshme.



11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombe tar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombe tar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombe tare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

IAL-ja ka nënshkruar disa marrëveshje me Universitetet të tjera partnere nga vendi dhe ndërkombe tar, institucione publike dhe private, organizata profesionale dhe ato të shoqërisë civile. Në kuadër të bashkëpunimit janë nënshkruar marrëveshje me Universitetin e Tiranës, Universitetin "Fan Noli", Universitetin "Luigj Gurakuqi", Universitetin "Aleksandër Moisiu", Universitetin Ndërkombe tar të Strugës, Bashkinë e Tiranës, Qëndrën ARSIS, Qëndrën Sociale "Të qëndrojmë së Bashku", Arkiva Qëndrore e Shtetit. Njëkohësisht, janë nënshkruar edhe disa marrëveshje dypalëshe me institucione ndërkombe tare si: Universiteti i Fogjas, Universiteti i Aquila-s, dhe Universiteti i Padova-s në Itali, Instituti Sigmund Freud i Vjenës, Istanbul Ayvansaray University, ISPE Kolegji Prishtine, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombe tar**

Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte ndërkombe tare është 11, numri i leksioneve/seminareve me lektorë të huaj 3, numri i pjesëmarrjeve në trajnime jashtë vendit 4, dhe numri i prezantimeve në aktivitete/konferenca jashtë vendit 20

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë**

Bashkëpunimi me institucionet e tjera konsiston në veprimtari të përbashkëta shkencore, projekte, shkëmbim stafi e studentesh, si dhe praktikë mësimore dhe profesionale të studenteve.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrije apo e shërbimeve prodhuuese;	Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm publik dhe privat për realizimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare përfshi edhe praktikat profesionale të studenteve.
Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e	Marrëveshjet e nënshkruara me institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.



njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të fryshtme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	Departamenti ka përgjegjësi për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin e praktikave profesionale për të cilat cakton një pedagog mbikëqyrës. Nevojitet një ndarje më e mirë e detyrave administrative brenda njësise bazë nisur dhe nga fakti që pjesa më e madhe e pedagogëve të këtij programi studimi janë pedagogë me kohë të pjesshme në mënyrë që informacioni dhe ngarkesa të mund të shpërndahet.
Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të fryshtme bashkëpunimi.	
Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.	
Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;	IAL-ja ka marrëdhënie bashkëpunimi me IAL homologe brenda dhe jashtë vendit (p.sh Universiteti Fan Noli, Universiteti i Tiranës, ISPE - Kolegji Prishtinë, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës) të cilat ndihmojnë në realizimin e objektivave të programit të studimit.
Kriteri 2 Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;	IAL-ja ka edhe marrëveshje me institucione publike dhe private, si dhe OFJ për realizimin e praktikës profesionale por në disa raste këto marrëveshje nuk janë detyruar dhe IAL-ja do të duhet të rivendosë bashkëpunimin apo të sigurojë bashkëpunime të reja.
Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;	Institucioni aplikon takimet me studentë Alumni si një praktikë e ofrimit të trajnimeve profesionale për studentët.
Kriteri 4 Institucioni bën një raport analistik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Në raportin vjetor të departamentit rapportohen marrëveshjet e arritura (3 në nivel departamenti) si dhe analizohet mundësia e zgjerimit të tyre.
Konkluzionet e vlerësimit:	
Institucioni disponon marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike dhe private, edhe në nivel departamenti por këto marrëveshje duhet të rifreskohen dhe shtohen, sidomos bashkëpunimet me institucionet akademike jashtë vendit. Bashkëpunimi i suksesshëm do të mundësojë realizimin e aktiviteteve ekstra-kurrikulare përfshi edhe praktikat profesionale të studenteve duke kontribuar në përmirësimin e programit të studimit, si dhe do të krijojë bashkëpunime të qëndësishme për partneritet në projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare, praktikë e dobishme për fuqizimin e komponentit kërkimor	



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se rekomandimet e lëna nga akreditimi i parë janë përmbushur kryesisht. Institucioni i ka plotësuar në tërësi 8 rekomandime, ndërkojë rekomandimi i 1-rë dhe ai i 5-të i Këshillit të Akreditimit nuk janë plotësuar.

IAL-ja ka siguruar që biblioteka të jetë një ambient i qetë dhe i përshtatshëm për të studiuar, si dhe ka krijuar edhe zyrën e karrierës. Fondi i bibliotekës është pasuruar me literaturën e kërkuar nga departamenti si dhe ofrohet pa pagesë aksesueshmëria në biblioteka online. Institucioni ka ngritur grupe pune me qëllim përmirësimin e programit të studimit dhe përshtatjen me kërkuesat e tregut të punës dhe standardet e cilësisë. Në këtë kuadër, janë përfshirë në programin e studimit edhe dy grup lëndësh me zgjedhje. Institucioni, gjithashtu ka angazhuar në mësimdhënie pedagogë me eksperiençë dhe grada e tituj shkencorë.


II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SWOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të fortë:

1. Një praktikë e mirë konsiderohet raporti vjetor i Departamenti i cili përfshin të dhëna të hollësishme përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me programet e studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar dhe vlerësimin e pedagogëve, rezultatet e arritura të studenteve, mjediset dhe biblioteka, veprimtaria kërkimore shkencore dhe financimi i aktivitetave të zhvilluara, marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe analiza SWOT, ku përvëç evidentimit të pikave të dobëta propozohen edhe masat që duhet të merren për përmirësimë në të ardhmen.
2. Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi zotëron kualifikime të ndryshme për specialitetin e lëndës që ofron, si dhe vijnë nga një përvojë e gjatë profesionale në fushën e mësimdhënieς, ose në drejtimet profesionale që ata përfaqësojnë. Ngarkesa e orëve mësimore e pedagogëve të angazhuar në këtë program studimi, vitin e fundit akademik (2018-2019) nuk i kalon 120 orë për pedagog.
3. Zyra e Karrierës dhe Alumnit siguron lidhjen e studentëve me tregun e punës, nëpërmjet aktivitetave me studentë të ftuar Alumni apo panairit të karrierës, trajnimeve të ndryshme në lidhje me prezantimin në një interviste pune, shkrimin e një CV. Kjo zyrë gjithashtu mban të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve.
4. Në vitin akademik 2018-2019, 7 nga 8 pedagogët me kohë të plotë të këtij programi studimi kanë grada dhe tituj shkencorë.
5. IAL-ja ofron mundësinë e bibliotekës online QUESTIA, e cila përmban libra akademike dhe artikuj shkencore në gjuhën angleze, të aksesueshmë pa pagesë nga studentët dhe stafi akademik. IAL ka shtuar fondin e bibliotekës me 172 tituj të ndryshëm, dhe ky fond pasurohet çdo fillim viti me literaturën e kërkuar nga departamenti për lëndët e programeve të studimit. Për bibliotekën institucioni gjithashtu ka siguruar një ambient me sipërfaqe 248.6 m², të përshtatshëm i cili ofron një mjesi të qetë dhe komod për të studiuar.

b. Pika të dobëta:

1. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë i angazhuar për realizimin e programit të studimit të ciklit të dyte Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik", gjatë periudhës 2012-2017



është mbuluar kryesisht nga personeli akademik i punësuar me kontratë (në periudhën 2012-2017 vetëm 2 pedagogë me kohë të plotë janë angazhuar në këtë program studimi). Përjashtim bën viti akademik 2018-2019 ku numri i pedagogëve me kohë të plotë është rritur ndjeshëm në raportin 8/5 duke përbërë 62% të personelit mësimdhënës. Gjithsesi rapporti duhet të jetë minimalisht 70% pedagogë me kohë të plotë, për të pasur një ekuilibër në përputhje me përcaktimet ligjore.

2. Programi i studimit financohet pothuajse 100% nga tarifat e shkollimit, të ardhura të cilat kanë pësuar 50% rënie në 6 vitet e fundit. IAL-ja nuk gjeneron të ardhura shtesë nga ofrimi i konsulencave apo shërbimeve ndaj të tretëve apo të përfitojë nga fonde dhe grante të ndryshme, të cilat janë burime alternative dhe mund të ndihmojnë në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare.
3. Institucioni ka hasur vështirësi në tërheqjen e studentëve me rezultate të larta nëse i referohemi notës mesatare hyrëse ku për vitin akademik 2017-2018 ka qenë 6.71, dhe ka ardhur në rënie kahasuar me vitet paraardhëse, në vitin akademik 2012-2013 nota mesatare hyrëse ka qenë 7.26. Gjithashtu, cilësia e studentëve në dalje ka një rritje jo të ndjeshme.
4. Programi i studimit vec lëndëve teorike, përfshin në një pjesë të madhe të programit mësimor (20%) aftësimin profesional (praktikës profesionale 6 ECTS) dhe kërkimin shkencor - mikro-tezën (6 ECTS). Pesha e praktikës profesionale duhet të ishte më e madhe në kahasim me kërkimin shkencor (mikrotezën) nisur nga profili profesional i programit të studimit.
5. IAL-ja në nivel institucional, nuk gjenerohen të ardhura shtesë nga ofrimi i konsulencave apo shërbimeve ndaj të tretëve apo nga fonde dhe grante të ndryshme, kërkimi shkencor është rezultat individual i personelit akademik jo i institucionalizuar dhe institucioni nuk mundëson kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik dhe atij mësimor shkencor.

c. Mundësitë:

1. IAL-ja në nivel institucional, duhet të bëjë përpjekje për të mundësuar kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik dhe atij mësimor shkencor nëpërmjet angazhimit dhe organizimit të kurseve dhe trajnimeve të mëtejshme.
2. IAL-ja duhet të krijojë infrastrukturën e nevojshme (zyra për kërkimin dhe zhvillimin e projekteve) për të identifikuar dhe zhvilluar bashkëpunime me institucionale partnere për të qenë pjesë e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, praktikë e dobishme përfuqizimin e komponentit kërkimor.
3. Institucioni disponon marrëveshje bashkëpunimi me institucionale publike dhe private, edhe në nivel departamenti por këto marrëveshje duhet të rifreskohen apo të sigurohen bashkëpunime të reja, sidomos bashkëpunimet me institucionet akademike jashtë vendit dhe institucionale ku mund të kryhen praktika profesionale.

d. Pengesat:

1. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi ka ardhur në rënie. Në vitin akademik 2012-2013 janë regjistruar 71 studentë kurse në vitin akademik 2017-2018 dhe 2018-2019 janë regjistruar 28 studentë (40% studentë më pak).
2. Në lidhje me situatën financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen, për periudhën 6 vjeçare konstatojmë që burimi kryesor i të ardhurave vjen nga tarifa e shkollimit të ardhura të cilat kanë një rënie me 50%.

Megjithatë, **disa çështje janë adresuar pjesërisht nga institucioni**, dhe vlerësojmë se ka ende hapësirë për tu konsideruar me qëllim përmirësimin e tyre.



Rekomandime:

1. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë i angazhuar për realizimin e programit të studimit është mbuluar kryesisht nga personeli akademik i punësuar me kontratë dhe vetëm 2 pedagogë me kohë të plotë janë angazhuar në këtë program studimi. Pavarësisht se vitin e fundit akademik institucioni ka rritur ndjeshëm numrin e pedagogëve me kohë të plotë, raporti është më i ulët se 70%, **prandaj rekmandoher që** në vazhdimësi institucioni të sigurojë respektimin e standardeve shtetërore të cilësisë përsa i përket raportit minimal të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit Master Profesional në "Qeverisje dhe Administrim Publik".
2. Gjithashtu, Institucioni ka hasur vështirësi në tërheqjen e studentëve me rezultate të larta, situatë e cila ka ardhur në rënien krasuar me vitet e mëparshme nëse i referohemi notës mesatare hyrëse, **prandaj rekmandoher që** institucioni të synojë të tërheqë studentëve të rinj me rezultate të larta nëpërmjet politikave të mbështetjes financiare për studentët e ekselencës duke reduktuar tarifat e shkollimit apo ofrimin e bursave të plota.
3. Grupi i vlerësimit të jashtëm, gjatë këtij procesi vlerësimi gjithashtu ka konstatur që programi i studimit financohet pothuajse 100% nga tarifat e shkollimit, të ardhura të cilat kanë pësuar 50% rënien në 6 vitet e fundit. Për më tepër IAL-ja nuk gjeneron të ardhura shtesë nga ofrimi i konsulencave apo shërbimeve ndaj të tretëve apo të përfitojë nga fonde dhe grante të ndryshme, **prandaj rekmandoher që** departamenti ta adresojë me prioritet këtë çështje dhe të shtojë përpjekjet për të siguruar numrin e nevojshëm të studentëve si dhe angazhimin e stafit në ofrimin e shërbimeve, konsulencave, përfshi edhe përsitimin nga grante, të cilat janë burime alternative dhe mund të garantojnë një qëndrueshmëri financiare më të sigurt në zhvillimin e këtij programi studimi. IAL-ja në nivel institucional, duhet të bëjë përpjekje për të mundësuar kualifikimin e mëtejshëm të stafit; si edhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme (zyra për kërkimin dhe zhvillimin e projekteve) për të identifikuar dhe zhvilluar bashkëpunime me institucionale partnere për të qenë pjesë e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare, praktikë e dobishme për fuqizimin e komponentit kërkimor.
4. Së fundmi, programi i studimit përveç lëndëve teorike, përfshin në një pjesë të madhe të programit mësimor (20%) aftësimin profesional (praktikës profesionale 6 ECTS) dhe kërkimin shkencor - mikrotezën (6 ECTS). Gjithsesi, vlerësojmë që raporti midis aftësimit profesional dhe kërkimit shkencor duhet të mëshojë më shumë nga aftësimi profesional nisur nga profili profesional i këtij programi studimi, **prandaj rekmandoher që** departamenti të rishikojë planin mësimor për të rritur peshën e praktikës profesionale në krahasim me kërkimin shkencor, mikrotezën.

SUMMARY ANALYSIS FOR THE EVALUATION OF THE STUDY PROGRAM

I. SUMMARY OF ANALYSIS FOR FULFILLMENT OF RECOMMENDATIONS FROM THE FIRST ACCREDITATION

The External Evaluation Group finds that the recommendations left by the first accreditation **are largely met**. The institution has fully met **8 recommendations**, while the **1st recommendation and the 5th recommendation of the Accreditation Council has not been completed**.

The HEI has ensured that the library is a quiet and convenient place to study and the HEI has created a career office. The library collection is enriched with the literature required by the department as well as being it provides free access to online libraries. The institution has set up working groups to improve the study program and adapt them to the labor market requirements and the quality standards. In this context, two elective courses are included in the study program. The institution has also engaged in teaching experienced pedagogues with scientific degrees and academic titles.




II. SWOT ANALYSIS (STRENGTHS, WEAKNESSES, OPPORTUNITIES, THREATS).

a. Strengths

1. The Annual Departmental Report is considered a good practice and it includes qualitative and quantitative data that relate to the study programs, validity of past accreditation, students' results and evaluations, academic staff hired, the University premises and library and bilateral agreements of the Institutions. In addition to the SWOT analysis, the University has also proposed measures to be undertaken in the future.
2. The academic staff in this study program holds several qualifications for the courses they teach and they come from long experiences in teaching or other related professional directions. Regarding the load of the full time faculty in this study program, for the academic year 2018-2019 does not surpass 120 hours per year for each faculty member.
3. The Alumni and Career Office secures the connection of students with the labor market, through activities with Alumni students and job fairs. As well as it offers various trainings for interviews for prospective candidates in the labor market and the training in the writing of professional CVs for current students. Also, it keeps records on graduated student employment.
4. For the academic year 2018-2019, 7 out of 8 full-time faculty of this program have scientific grades and academic titles.
5. The university offers the online platform QUESTIA, which contains academic books and scholarly articles in English, which are accessed from both students and faculty. In the last six years the University has added 172 other titles and each year further enrichment takes place after demands from departments. For the library, the institution has secured a room of 248.6 m², which offers a quiet and comfortable environment for students to study.

b. Weak points:

1. The full-time academic staff employed in the program of second cycle Professional Master in 'Governance and Public Administration', in the period from 2012 to 2017 has been almost exclusively covered by part-time faculty (in this period only 2 faculty members have been employed full-time). Only during the last academic year 2018-2019, efforts are being made to address this when the number of full-time faculty has increased to 8/5 levels, thus constituting 62% of overall faculty body. Yet, this number is below the 70% required by the law.
2. The study program is financed by almost 100% of the tuition fees, which have fallen by 50% in the last 6 years. HEI does not generate additional income from providing consultancy or services to third parties or it does not benefit from various funds and grants, which may be alternative sources that can help secure financial sustainability.
3. The institution has encountered difficulties in attracting students of excellence if referred to the average entrance grades where for the academic year 2017-2018 it was 6.71 and has fallen compared to the previous years, in the academic year 2012-2013 the average entrance grade has been 7.26. Also, the quality of outgoing students has an insensitive growth.
4. The study program, apart from theoretical subjects, includes a large part of the curriculum (20%) the vocational training (professional practice 6 ECTS) and the research, micro-thesis (6 ECTS). The weight of the professional practice should be greater compared to research (micro-thesis) given the professional profile of the study program.
5. The HEI at the institutional level do not generate additional revenues from providing consultancy or services to third parties or from various funding and grants, the scientific research is the result of



individual academic staff and it is not institutionalized, moreover the institution does not provide further qualification for its academic and teaching staff.

c. Opportunities:

1. The University, in institutional level, has to make efforts to increase the further qualification of academic staff as well as the research staff through faculty development workshops, continuous trainings etc.
2. Institution needs to create the proper infrastructure (the office for research and project development) to identify and develop other cooperation with partner institutions in order to be eligible for domestic and international projects, which is imperative in order to strengthen the component of research.
3. The institution has several signed memorandums with public and private institutions but these agreements need to refresh and new ones need be signed, especially with Universities abroad as well as domestic institutions where students could make internships.

d. threats:

1. The number of the students registered in this study program has been in decline. During 2012-2013, 71 students have registered, whereas in 2017-2018 and 2018-2019 only 28 students have registered (thus 40% less).
2. Regarding the financial situation and the revenues for the future, for the 6 year period under consideration, we note that the major source of income for the institution is the revenue generated from students' fees, which on the other hand have a decline of 50%.

However, some issues are partially addressed by the institution, and we consider that there is still room to be considered in order to improve them.

Recommendations:

1. Full-time academic staff engaged in the implementation of the study program is mainly covered by the academic staff with contract and only two full-time lecturers were engaged in this study program. Despite, the fact that in the last academic year the institution has considerably increased the number of full-time lecturers, the ratio is still lower than 70%, so it is recommended that the institution should ensure in the future that state quality standards are fulfilled in terms of the minimum fulltime academic staff committed for the implementation of the Master Program in "Governance and Public Administration".
2. Also, the Institution has faced difficulties in attracting students of excellence with high grades, a situation that has been deteriorating compared to previous years if referring to the average entrance grades, so it is recommended that the institution should aim to attract incoming students with higher average grades through financial support policies for students of excellence either by reducing tuition fees or by providing full scholarships.
3. The External Evaluation Group during this evaluation process has also found that the study program is funded almost 100% from the tuition fees, which have fallen by 50% in the last 6 years. Moreover, the HEI does not generate additional revenue from providing consultancy or services to third parties or it does not benefit from various funding and grants, so it is recommended that the department prioritize this issue and increase its efforts to provide the necessary number of students as well as engaging its staff in service delivery, consultancy, including grants, which are alternative sources and can



guarantee financial sustainability in the implementation of this study program. HEI at the institutional level should make efforts to enable the further qualification of its staff; as well as to create the necessary infrastructure (project research and development office) in order to identify and develop collaborations with partner institutions and be part of national and international projects, a useful practice for strengthening the research component.

4. Finally, the study program, in addition to theoretical subjects, includes a large part of the curriculum (20%) vocational training (professional practice 6 ECTS) and the research - micro-thesis (6 ECTS). However, we assess that the ratio between vocational training and research should be higher for the professional training given the professional profile of this study program, so it is recommended that the department review the curriculum and increase the weight of the professional practice compared to the scientific research, micro-thesis.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm

1. PhD Dorian JANO
2. PhD Ilir KALEMAJ

